



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

TË PËRKUSHTUAR NDAJ ALLAHUT

Harun Yahya

Botuar nga: Botues privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit

Lexuesit.....	5
Rreth autorit.....	6
QËLLIMI I JETËS SË BESIMTARIT: PËLQIMI I ALLAHUT.....	11
Perpjekjet e duhura për kënaqësinë e Allahut.....	15
Të njohësh shpirtin.....	21
Ruajtja nga idhujtaria.....	22
TË ARRISH SHUMË NGA KËNAQSITË E ALLAHUT.....	26
Celësi i pëlqimit të Allahut: Ndërgjegja.....	36
Të duash për hir të Allahut.....	37
Vetitë e besimtarëve.....	45
Shtypja kundër besimtarëve.....	52
JETA NË SHOQËRINË E PADITUR.....	56
Kriteret e vlerësimit të njerëzve në shoqërinë e «paditur».....	63
Prijësit e Shoqërive ku Zotërimi i Parave është Kriteri Bazë.....	68
Moralet në shoqërinë e të paditurve.....	71
Dëshira për të jetuar përgjithmonë.....	71
Konceptimi i Fesë në Shoqërinë e Paditurisë.....	76
VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË PRANOJNË TË ADHURUAR TË TJERË VEC ALLAHUT: FERRI.....	80
VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KËRKOJNË VETËM PËLQIMIN E ALLAHUT: PARAJSA.....	83
KEQKËPTIMI I EVOLUCIONIT.....	87

Rrëzimi shkencor i Darwinizmit	88
Hapi i Parë i Pakapërcyeshëm: Origjina e jetës.....	89
<<Jeta Vjen nga Jeta>>	90
Përpyqje pa Rezultat në Shekullin e Njëzetë.....	91
Struktura Komplekse e Jetës.....	92
Mekanizma Imagjinare të Evolucionit	93
Përpyqjet e Lamarkut.....	94
Neo-Darvinizmi dhe Mutacionet	95
Mbetjet Fosile: Asnjë Gjurmë Formash të Ndërmjetme.	97
Shpresat e Copëtuara të Darvinit	98
Përralla e Evolucionit Njerëzor	99
Teknologjia e Syrit dhe e Veshit	102
Një Fë Materialiste	106
Teoria e Evolucionit është Magjepsja më e Fuqishme në Historinë e Botës	107

LEXUESIT

Arsyeja pse një kapitull i vecantë i dedikohet përmbysjes së teorisë së evolucionit është se kjo teori përbën bazën e të gjitha filozofive anti-shpirtërore. Meqë Darwinizmi refuzon faktin e Krijimit, dhe si rrjedhim ekzistencën e Allahut, gjatë 140 viteve të fundit ai ka bërë që shumë njerëz të braktisin besimin e tyre ose të bien në dyshime. Si rrjedhim, të tregosh se kjo teori është një mashtrim është një punë shumë e rëndësishme, që është e lidhur ngushtë me fenë. Është shumë e nevojshme që ky shërbim i rëndësishëm ti ofrohet çdokujt. Prandaj na duket e përshtatshme të shpenzojmë një kapitull si përmbledhje e kësaj teme.

Në të gjithë librat e autorit, çështjet e lidhura me besimin janë shpjeguar nën dritën e ajeteve Kur'anore dhe njerëzit janë të ftuar të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë me to. Të gjitha subjektet që kanë të bëjnë me fjalët e Allahut janë shpjeguar në mënyrë të tillë që të mos lihet vend për dyshime apo pikëpyetje në mendjen e lexuesit. Stili i përdorur është i sqartë, i thjeshtë dhe i rrjedhshëm që siguron që cdo njeri i çdolloj moshe dhe i çdolloj grupi shoqëror mund ti kuptojë lehtë librat. Kjo metodë përshkrimi efikase dhe e qartë bën të mundur leximin e tyre në një herë të vetme. Edhe ata që e refuzojnë rigorozisht botën shpirtërore, influencohen nga faktet e numëruara në këto libra dhe s'mund ta refuzojnë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky libër dhe të gjitha botimet e tjera të Harun Jahjas mund të lexohen në mënyrë individuale ose të diskutohen në grup. Ata lexues të cilët dëshirojnë të përfitojnë nga librat do shohin që

diskutimi është mjaft i dobishëm pasi ata do të mund të lidhin përshtypjet dhe eksperiencat e tyre me njëri-tjetrin.

Përveç kësaj, është një shërbim mjaft i madh që i bëhet fesë nëse kontribuojmë me prezantimin dhe qarkullimin e këtyre librave që janë shkruar vetëm për kënaqësinë e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë mjaft bindës, prandaj, për ata që duan t'ia komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, një nga metodat më efikase është të inkurajosh ata t'i lexojnë këto libra.

Shpresojmë që lexuesi do ketë kohë të shohë përmbledhjen e librave të tjerë në faqet e fundit të këtij libri dhe të vlerësojë burimin e pasur të materialeve që kanë lidhje me besimin, të cilët janë shumë të dobishëm dhe një kënaqësi për tu lexuar.

Në to, nuk do të gjeni, si në disa libra të tjerë, pikëpamjet personale të autorit, shpjegime të bazuara në burime të dyshimtë, stile jovëzhguese ndaj respektit dhe nderimit të duhur të çështjeve të shenjta, apo vlerësime të dyshimta dhe pesimiste që kjojnë devijime në zemër.

RRETH AUTORIT

Autori, i cili shkruan nën pseudonimin Harun Jahja, ka lindur në Ankara në 1956. Pasi përfundoi edukimin fillor dhe të mesëm në Ankara, ai më pas studioi artet në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll. Që nga viti 1980, autori ka publikuar shumë libra me përmbajtje politike, fetare dhe shkencore. Harun Jahja njihet shumë si një autor që ka shkruar punime mjaft të rëndësishme

duke demaskuar mashtrimet e evolucionistëve, jovlershmërinë e thënieve të tyre dhe lidhjet e errta ndërmjet Darwinizmit dhe ideologjive të përgjakshme si fashizmi apo komunizmi.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat Harun dhe Jahja, në kujtim të dy profetëve të çmuar që luftuan kundër mungesës të besimit. Shenja e Profetit në kapakun e këtij libri është simbolik dhe lidhet me përmbajtjen e tij. Ai përfaqëson Kur'anin (shkrimin e fundit) dhe profetin Muhammed, i fundit i profetëve. Nën udhëheqjen e Kur'anit dhe sunnetit, autori i vë qëllim vetes të hedhë poshtë parimet bazë të ideologjive anti-fetare dhe të thotë «fjalën e fundit», në mënyrë që të bëjë të heshtë plotësisht çdolloj kundërshtimi ndaj fesë. Shenja e Profetit të fundit, të cilit iu dha urtësia përfundimtare dhe perfeksioni moral, përdoret si shenjë e qëllimit të tij për të thënë këtë fjalë të fundit.

Të gjitha veprat e autorit përqendrohen rreth një pike: t'i bëjë të ditur njerëzve mesazhin e Kur'anit, t'i inkurajojë ata që të mendojnë për çështjet bazë të besimit (siç është ekzistenca e Allahut, njëshmëria e Tij dhe bota e përtejme), dhe të tregojë themelet e dobta dhe ideologjitë e shtrembëta të sistemeve ateiste.

Harun Jahja gëzon një lexueshmëri të gjërë në shumë vende, nga India në Amerike, Angli e Indonezi, Poloni e Bosnjë, dhe Spanjë e Brazil. Disa nga librat e tij janë të përkthyer në anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, portugjisht, arabisht, shqip, rusisht, serbo-kroatisht, polonisht, etj dhe pëlqehen nga lexuesit në mbarë botën.

Si shumë të vlerësuara, këto vepra kanë qenë mjete shëruese të besimit në Allahun për shumë njerëz dhe tek të tjerë ndihmuan për të fituar një vëzhgim më të thellë në fenë e tyre. Urtësia dhe stili i sigurtë dhe i lehtë për tu kuptuar i jep këtyre librave një efekt të veçantë i cili influencon

direkt në atë që i lexon apo studion ato. Të mbrojtur nga kundërshtimet , këto punë karakterizohen nga veçoritë e tyre si: efektivitet i menjëhershëm, rezultate të qarta dhe mosrefuzim. Është e pamundur që ata që i lexojnë këto libra dhe mendojnë seriozisht mbi ta, të mund të mbrojnë më sinqerisht filozofinë materialiste, ateizmin apo çdolloj filozofie apo ideologjie të tillë. Edhe nëse ata vazhdojnë të sillen kështu, do të ishte vetëm një këmbëngulje sentimentale meqë këto libra refuzojnë këto ideologji që nga themelet e tyre. Të gjitha lëvizjet e kohëve të fundit të mohimit tani po mposhten ideologjikisht, kjo për shkak të koleksionit të librave të shkruar nga Harun Jahja.

Nuk ka dyshim se këto veçori janë rezultat i urtësisë dhe qartësisë së Kur'anit. Autori modestisht kërkon t'i shërbejë si mundet gjetjes së rrugës së drejtë të Allahut për njerëzimin. Në botimin e këtyre veprave nuk arrihet asnjë përfitim material.

Duke marrë parasysh këto fakte, ata që inkurajojnë njerëzit të lexojnë këto libra, të cilat të hapin «sytë» e zemrës dhe i bëjnë ata shërbyes më të përkushtuar ndaj Allahut, kryejnë një shërbim të paçmueshëm.

Ndërkohë, do të ishte një shpenzim kohe dhe energjie të propagandosh libra që krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve, i çojnë njerëzit në kaos idesh, të cilët, nuk kanë efekt të fortë e të saktë në heqjen e dyshimeve nga zemrat e njerëzve, sic është vërtetuar gjithashtu nga eksperiencat e mëparshme. Është e pamundur që librat që theksojnë më tepër aftësinë letrare të autorit sesa qëllimin fisnik të shpëtimit të njerëzve nga humbja e besimit të arrijnë të kenë efekt kaq të madh. Ata të cilët dyshojnë në këtë mund të shohin gati që arsyeja e vetme e librave të

Harun Jahjes është të munda mosbesimin dhe të mbjellë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe impakti i këtij shërbimi shfaqen në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet në mendje: Arsyeja kryesore e ashpërsisë të vazhdueshme, konfliktit dhe të gjitha mynxyrave që shumica e njerëzve kalojnë, është mbizotërimi ideologjik i mosbesimit. Kjo gjendje mund të përfundojë vetëm me mposhtjen ideologjike të mosbesimit dhe duke treguar mrekullitë e krijimit dhe moralitetin Kur'anor në mënyrë që njerëzit të jetojnë me të. Duke marrë parasysh gjendjen e botës sot, që i çon njerëzit drejt dhunës, korrupsionit dhe konfliktit, është e qartë që ky shërbim duhet të ofrohet sa më shpejt dhe me sa më rendiment. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Nuk është tepër të thuash që koleksioni i librave të Harun Jahjas ka marrë përsipër këtë rol kryesues. Me dëshirën e Allahut, këto libra do të jenë një burim me të cilin njerëzit në shekullin e 21-të do arrijnë paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Veprat e autorit përfshijnë: Urdhëri i ri Masonik, Islami kundër terrorizmit, Shkatërrimet që Darwinizmi i solli njerëzimit, 'Dora sekrete' në Bosnjë, Pas perdeve të holokaustit, Pas perdeve të terrorizmit, Zgjidhja: vlerat e Kur'anit, Shenjat e ditës së fundit, Gjunjëzimi i evolucionit, Përgjigje të sakta evolucionistëve, Keqkuptimi i evolucionit të specieve, Popujt e zhdukur, Profeti Musa (as), profeti Jusuf (as), Profeti Sulejman (as), Profeti Muhammed (saus), Koha e artë, Rëndësia e evidencave të Krijimit, E vërteta e jetës së kësaj bote, Të njohësh të vërtetën, Materia: një emër tjetër për iluzionin, Magjia e errët e Darwinizmit, Inxhinjeria në natyrë, Teknologjia imiton natyrën, Allahu njihet nëpërmjet arsyes, Kur'ani udhëheq drejt shkencës, Origjina e vërtetë e jetës, Një varg mrekullish, Krijimi i universit, Mrekullitë e Kur'anit, Vetësakrifikimi dhe modelet

e sjelljes inteligjente tek kafshët, Fundi i Darwinizmit, Mrekullia e gjelbër: Fotosinteza, Mrekullia tek qeliza, Mrekullia tek syri, Mrekullia tek merimanga, Mrekullia tek milingona, Mrekullia e Krijimit tek bimët, Mrekullia tek atomi, Mrekullia tek fara, Mrekullia tek hormonet, Mrekullia tek trupi njerezor, Mrekullia tek proteina, Mrekullia e mikrobotës, Sekretet e ADN-së, etj.

Veprat e tjera të autorit rreth Kur'anit përfshijnë: Konceptet bazë në Kur'an, Vlerat morale të Kur'anit, Braktisja e shoqërisë mohuese, Shtëpia e vërtetë e besimtarëve: Parajsa, Njohuri të Kur'anit, Indeksi i Kur'anit, Sekretet e hipokritit, Emigrimi për çështjen e Allahut, Emrat e Allahut, Përgjigje nga Kur'ani, Vdekja, ringjallja, ferri, Beteja e të dërguarve, Armiku i betuar i njeriut: satani, Lutjet në Kur'an, Teoria e evolucionit, Rëndësia e vetëdijes në Kur'an, Dita e Ringjalljes, Mos harro, Rëndësia e durimit në Kur'an, Informacion i përgjithshëm nga Kur'ani, Para se të pendohesh, Profetët tanë thonë, Mëshira e besimtarëve, Frika e Allahut, Jezusi do kthehet, Bukuritë e paraqitura në Kur'an për jetën, Urtësia e vërtetë sipas Kur'anit, Islami: feja e së lehtës, Të shohësh për mirë çdogjë, Disa sekrete të Kur'anit, Guximi i besimtarëve, Drejtësia dhe toleranca në Kur'an, Ata që nuk e dëgjojnë Kur'anin, Sinqeriteti në Kur'an, Metodrat e gënjeshtarit në Kur'an.

QËLLIMI I JETËS SË BESIMTARIT: PËLQIMI I ALLAHUT

...Allahu udhëheq të gjithë ata të cilët kërkojnë Kënaqësinë e Tij drejt rrugëve të paqes dhe Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë me Vullnetin e Tij dhe i udhëzon në Rrugën e Drejtë (Islam).

(Sure el-Ma'ideh: 16)

Çfarë e bën një Musliman të ndryshëm nga njerëzit e tjerë? Jomuslimanët mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje në shumë mënyra; ata mund të flasin për ndryshime kulturore dhe morale, për «këndvështrime të ndryshme të botës» apo për vlera që ata i mohojnë haptas. Ndryshe, disa mund të thonë që ndryshimi i ka rrënjët e tij në ideologjitë e ndryshme që përqafojnë Muslimanët. Megjithatë, gjithë këto ndryshime kanë të bëjnë me ndryshime «të dukshme» që duket se janë pasoja të një të tilli më themelor. Shpesh, ata nuk i kuptojnë arsyet që fshihen poshtë këtij ndryshimi. (Në fakt, pse ata nuk janë Muslimanë është se ata nuk e kuptojnë këtë ndryshim). Përpara se të shpjegojmë vetinë bazë e të qenit musliman duhet të theksojmë diçka tjetër: Kur ne flasim për një «Musliman», ne nuk po i referohemi dikujt që e ka të shkruar «Musliman» mbi pashaportë. Në fakt, Musliman është emri që Allahu i vë atyre që përkrahin fort fenë e Tij. Vetia themelore, sipas Kur'anit, që i dallon Muslimanët nga njerëzit e tjerë është vëmendja e tyre ndaj fuqisë të pafundme të Allahut. Megjithatë, kjo nuk do të thotë gjithmonë afirmimin e ekzistencës së një Krijuesi. Kur'ani e nënvizon këtë fakt si më poshtë:

Thuaju: «Kush ju sjell furnizim nga qielli dhe nga toka dhe kush është Zotëruesi i të dëgjuarit dhe të shikuarit? Dhe kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Dhe kush

është rregulluesi dhe sunduesi i të gjitha çështjeve?». Do të thonë të gjithë «Allahu». Thuaju: «A nuk do të keni atëherë frikë nga Ndëshkimi i Allahut?»

Ky është Allahu, Zoti juaj i Vërtetë. Kështu pas së vërtetës, ç'gjë tjetër mund të ketë përveçse të gabuarës? Si atëherë keni humbur (nga e vërteta drejt mohimit dhe shkarjes) ?

(Sure Junus: 31-32)

Në ajetet e mësipërme, pyetjet i janë bërë atyre që e njohin ekzistencën e Allahut, i pranojnë veçoritë e Tij dhe, pavarësisht nga të gjithë këto veçori, nuk kanë frikë nga Allahu dhe si rrjedhim largohen prej Tij . (Në fakt as shejtani nuk e mohon ekzistencën e Allahut).

Të kuptosh fuqinë e Allahut nuk është vetëm një thënie verbale . Besimtarë janë ata që pranojnë ekzistencën e Allahut dhe madhësitinë e Tij, «janë të qëndrueshëm në detyrimet e tyre» ndaj Tij dhe i drejtojnë të gjitha qëllimet e tyre ndaj Tij dhe ecin në dritën e këtij realiteti që u është bërë i dukshëm. Të tjerët, nga ana tjetër, janë njësoj si ata që e mohojnë Allahun, të përmendur edhe këta në ajetet e mëparshme, që nuk i kryejnë detyrimet e tyre ndaj Allahut, pavarësisht nga pranimi i tyre për ekzistencën e Tij.

Përgjatë jetës së tyre, njerëz të tillë mbeten plotësisht të pavëmendshëm ndaj Allahut, Krijuesit të njeriut. Se kujt ia detyrojnë jetën e tyre apo, si dhe pse iu është dhuruar kjo jetë mbi tokë, janë pyetje me të cilat ata nuk e shqetësojnë veten e tyre. Ata përballojnë një lloj jete plotësisht të veçuar nga Allahu dhe feja e Tij. Megjithatë, krahasimi i mëposhtëm në Kur'an e tregon qartë që një jetë e tillë qëndron mbi baza të kota dhe të kalbura dhe është e dënuar të shkatërrohet:

A është atëherë më i miri ai i cili i vuri themelin e ndërtësës së tij tek përkushtimi ndaj Allahut dhe të Kënaqësisë së Tij të Vyer, apo ai i cili vuri themelin e ndërtësës së tij të paqëndrueshëm buzë greminës, saqë u thërrmua bashkë me të në Zjarrin e Xhehenemit? Dhe Allahu nuk i do keqbërësit.

(Sure et-Teube: 109)

Ashtu siç na informon ajeti i mësipërm, jetët e atyre që u mungon besimi, si të përshkruara në Kur'an, themelohen "buzë greminës". Qëllimi kryesor i mosbesimtarëve është arritja e lumturisë dhe paqes «në këtë botë». Kështu, ajo që ata duan më shumë është që të bëhen të pasur. Dhe përpiqen shumë për t'ia arritur kësaj me të gjitha mjetet mendore dhe fizike. Për të tjerë, të jesh një person i njohur dhe i respektuar është qëllimi i jetës; ata do të bënin gjithçka për të fituar respekt publik. Megjithatë, këto s'janë asgjë veç qëllime boshe që do vaniten kur të vijë vdekja mbi ta. Disa prej tyre, madje kujtojnë se kanë arritur qëllimet e tyre në këtë botë.

Një besimtar, sidoqoftë, është tërësisht i njohur me ekzistencën dhe fuqinë e Allahut. Ai e di pse Allahu e krijoi dhe cilat janë premtimet e Tij për të. Për këtë arsye, udhëzimi kryesor në jetën e besimtarit është të jetë një shërbëtor me të cilin Allahu të jetë i kënaqur. Ai i përdor të tëra mënyrat dhe përpjekjet për të arritur qëllimin e tij. Me këtë rast, ai zgjidh misterin e vdekjes: për shumë njerëz ajo s'është gjë tjetër vetëm fundi, kurse për besimtarin vdekja nuk është një shuarje por një fazë kalimtare për në jetën e vërtetë.

Jobsimtarët e mendojnë vdekjen si «një aksident të vetë-gjeneruar», ashtu siç e mendojnë dhe jetën të ketë lindur spontanisht dhe rastësisht. Fakti është se, sido që të jetë, Allahu krijon jetën

dhe vetëm Ai mund ta marrë. Vdekja, që në asnjë mënyrë nuk është rastësi apo aksident, është një ngjarje që ndodh sipas ligjit të Allahut në një moment dhe vend të caktuar.

Nje Musliman është një person i cili kupton që Allahu ka fuqi mbi të gjitha gjërat dhe se vdekja nuk është fundi por një kalim në vendqëndrimin real të njeriut (bota e Pertejme). I njohur me këto fakte, ai e eviton me kujdes ndërtimin e jetës së tij “buzë greminës”. Ai kthehet nga Allahu, duke e ditur se Ai është Zotëruesi i vërtetë dhe Krijuesi i jetës, vdekjes dhe asaj që vjen pas saj. Në këtë sistem të krijuar nga Allahu, ai kupton që pasuria, pozita shoqërore apo pamja e bukur nuk janë mjetet që e çojnë njeriun drejt suksesit; ato janë vetëm «raste» që ndodhin nën urdhërat e Allahut, që vlejnë vetëm për një periudhë të shkurtër kohe.

Çelsi i sistemit që Allahu ka krijuar është pranimi i Tij. Kjo sepse Allahu udhëzon vetëm ata që kërkojnë aprovimin e Tij.

...Allahu udhëheq të gjithë ata të cilët kërkojnë Kënaqësinë e Tij dhe Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë me Vullnetin e Tij dhe i udhëzon në Rrugën e Drejtë (Islam).

(Sure el-Ma’ideh: 16).

Një Musliman është i tillë sepse ai kërkon aprovimin e Allahut. Ky është dhe dallimi kryesor mes Muslimanëve dhe njerëzve të tjerë. Muslimanët e shohin fenë si një mënyrë për të fituar kënaqësinë e Allahut, kurse shumica e njerëzve e marrin këtë si një sistem bestytish që zënë një pjesë të mirë të jetës së tyre.

Në të vërtetë, në këtë pikë shfaqet papritur dallimi mes Muslimanëve të vërtetë dhe të atyre që i imitojnë ata (hipokritët). Muslimanët e përqafojnë fenë si një rrugëkalim drejt kënaqësisë së

Allahut. Për hipokritët, kjo është diçka nga e cila ata përfitojnë. Për këtë arsye, faljet e hipokritit kanë natyrë «pretencioze» (Sure el-Ma'un: 6), ndërsa Muslimanët falen me përulje (Sure al-Mu'minun: 1-2). Në mënyrë të ngjashme, ndërkohë që Muslimanët i shpenzojnë paratë e tyre për çështjen e Allahut, hipokritët i shpenzojnë për të lënë mbresë tek njerëzit e tjerë dhe jo për të fituar kënaqësinë e Allahut.

O ju që keni besuar! Mos e jepni Sadakanë (lëmoshën) duke e ndjekur me njoftime për të treguar bujarinë apo me lëndime, si ai që shpenzon pasurinë e tij për t'u parë nga njerëzit, dhe ai nuk beson në Allahun, as edhe në Ditën e Fundme. Shembulli i tij është si një gur i lëmuar mbi të cilin ka fare pak pluhur; mbi të bie një shi i rrëmbyer që e lan atë dhe nuk mbetet gjurmë pluhuri në të. Ata nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë me atë që kanë fituar. Dhe Allahu nuk e drejton popullin jobesimtar.

(Sure el-Bekare: 264)

PERPJEKJET E DUHURA PËR KËNAQËSINË E ALLAHUT

Njeriu përpiket shumë për të fituar mirësi të kësaj bote, të cilat i mendon si qëllimi përfundimtar i jetës së tij. Ai bën ç'të mundet për të arritur mirëqënie materiale, njohje të shtresës shoqërore apo përfitime të tjera të kësaj bote. Për një «fitim të vogël» (Sure et-Teube: 9) që do t'i rrëshkasë nga duart shumë shpejt, ai bën një përpjekje me të gjitha energjitë e tij.

Muslimanët, që shpresojnë në një shpërblim shumë më të madh, që është Kënaqësia e Allahut dhe Kopshti i Tij, gjithashtu përpiqen shumë për çështjen e tyre. Për këtë veçori, Allahu thotë:

Kushdo që dëshiron gjërat kalimtare (të kënaqësisë së kësaj bote), Ne ia japim atij menjëherë çfarë Ne duam dhe për kë Ne duam. Pastaj, mbas kësaj Ne kemi përcaktuar për të Xhehenemin, aty do të digjet i përçmuar dhe i flakur tej. Dhe kushdo që dëshiron Jetën e Fundit dhe përpiqet dhe i shërben asaj me mundin që duhet për të duke qenë besimtar, atëherë të tillët janë ata që përpjekja e të cilëve do të jetë e pëlqyer (e falenderuar dhe e shpërblyer nga Allahu).

(Sure el-Isra': 18-19)

Një besimtar përpiqet «me mjetet e duhura» për pranimin e Allahut dhe për Botën tjetër. Ai «shet» pronën e tij dhe jetën e tij për hir të Allahut. Në Kur'an, kjo karakteristikë e besimtarëve shpjegohet si më poshtë:

Me të vërtetë Allahu ka blerë nga besimtarët jetën e tyre dhe pasurinë e tyre me Çmimin se i tyre do të jetë Xhenneti. Ata luftojnë për Çështjen e Allahut, kështu që ata vrasin dhe vriten. Është një premtim i vërtetë të cilin Ai ia detyroi Vetes në Teurat, Inxhil dhe në Kur'an. E kush është më i vërtetë në besën e tij sesa Allahu? Atëherë gëzohuni në marrëveshjen që keni përfunduar. Ky është ngadhënjimi madhështor.

(Sure et-Teube:111)

Besimtari nuk do hasi vështirësi në rrugën e Allahut, nëse ai ia ka shitur «pronën dhe jetën e tij» Allahut. Atë s'e tërheq asgjë përveç kënaqësisë së Allahut. Duke e ditur se ai nuk «e zotëron» trupin dhe pronën e tij, ai nuk i ndjek kurrë dëshirat e tij (nefset). Allahu është zotëruesi i trupit të

tij dhe i çdo gjëje që ai ka, dhe ato do t'i vihen në shërbim sipas dëshirës së Allahut. Gjithashtu, do të provohet nga Allahu edhe nëse vendosmëria e dikujt është serioze. Një besimtar nuk duhet t'i shmangë betejat në rrugëkalimin e Allahut. Kjo sepse, hipokritët mund të kryejnë ndonjë veprë që duket sikur përputhet me kënaqesinë e Allahut (por jo veprën e duhur), për të pasur ndonjë «përfitim të lehtë».

Po të kishte qenë një përfitim i afërt dhe një udhëtim i i lehtë, ata do të kishin ardhur pas, por largësia ishte e madhe për ta dhe do të betoheshin për Allahun, «Vetëm sikur të mundeshim, pa sigurisht që do të dilnim bashkë me ju». Ata shkatërrojnë veten e tyre dhe Allahu e di se ata janë gënjeshtarë.

(Sure et-Teube: 42).

Prandaj, i vetmi kriter për të qenë një besimtar është të ndjesh një dëshirë të sinqertë për të arritur pranimin e Allahut dhe të mos ndalesh para sakrificave në rrugën e Allahut kur rrethanat i kërkojnë këto sakrifica.

Besimtarët janë ata të cilët «u zgjodhën për një qëllim të lartë duke u dhuruar mirësinë e mesazhit të përkujtimit të Shtëpisë (së Fundit të njerëzve)» (Sure Sad:46). Një besimtar nuk kërkon asgjë përveç miratimit të Allahut. Ai shpreson ta kënaqë Allahun, të ketë meshirën e Tij dhe të fitojë Parajsën, sepse «kushdo, mashkull apo femër qoftë dhe është besimtar i vërtetë në njësinë e Allahut, një i tillë do të hyjë në Xhennet dhe atyre nuk do t'i bëhet as padrejtësia më e vogël qoftë edhe sa Nakira (lëvozhgë e bërthamës së hurmës)» . (Sure an-Nisa':124)

Siç e pamë, Kur'ani na jep një pamje të shtjelluar qartë të besimtarit. Parajsa është vendi i atyre që «kanë besim të vendosur» në Allahun dhe në Jetën e Pastajme (Sure Lukman: 4) dhe pastaj «përpiqen me të gjitha mjetet e duhura» në rrugën e Allahut. Fundi i atyre që «respektojnë Allahun me anë të fesë se vërtetë» dhe i vendosin interesat e pavlera të kësaj bote pranë kënaqësisë së Allahut, përshkruhet kështu në Kur'an:

Dhe nga mesi i njerëzve është dhe ai i cili adhuron Allahun si të ishte mu në cak (të dyshimit): nëse i bie e mirë, ai kënaqet me të, por nëse e godet ndonjë sprovë, ai kthehet prapë nga vetja e vet duke humbur kështu të dyja, edhe këtë botë edhe Jetën e Fundit. Kjo është humbje e qartë.

(Sure el-Haxh: 11)

Besimtarët janë lakmues të botës tjetër. Allahu u premtun atyre një jetë të përhershme. Zoti ynë i premtun besimtarëve që Ai do t'i japë edhe një jetë të mirë shërbyesve të tij besues edhe në këtë botë, madje. Por kjo s'do të thotë aspak se ata nuk do të hasin ndonjë vështirësi apo shqetësim në këtë botë. Vuajtjet që ndeshin krijohen për t'i vënë ata në provë dhe për t'i bërë më të pjekur.

Pengesat që has një besimtar janë, në dukje, situata të vështira, por ku ato pranohen me përlulje dhe bindje, Allahu e liron atë nga të gjitha ato vështirësi. Për shembull, kur njerëzit e tij u përpoqën ta hidhnin Profetin Ibrahim (a.s.) në zjarr për shkak të besimit të tij, përgjigjia e tij ishte tamam e një Muslimani; ai parapëlqeu të hidhej në zjarr sesa të largohej nga besimi i tij apo nga urdhërat e Allahut. Të hidhesh në zjarr është dhimbja më e tmerrshme fizike që mund të provojë ndonjë qenie njerëzore në këtë botë. Megjithatë, Ibrahim (a.s.) që e përballoi këtë provë nga Allahu në mënyrën më përlulëse e me bindje, u shpëtua nga kjo me Dëshirën e Allahut dhe nuk u dëmtua aspak.

(Ibrahimi) u tha: «A adhuroni atëherë ju përveç Allahut gjëra që as nuk ju sjellin juve ndonjë të mirë dhe as nuk ju dëmtojnë? Turp për ju dhe përmbi ata që ju adhuroni në vend të Allahut! A nuk keni mend, pra?» Ata thanë: «Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, në do të veproni gjë». Ne thamë: «O Zjarr! Bëhu i ftohtë dhe paqë e siguri për Ibrahimin!» Dhe ata deshën ta dëmtonin atë; por Ne i bëmë ata humbësit më të mëdhenj.

(Sure el-Enbija: 66-70).

Fakti që, nuk do kenë asnjë dëm ata që nuk kanë frikë të humbasin çdogjë ndërsa përpiqen për çështjen e Allahut dhe se ata do të fitojnë mjaft shpërblime materiale dhe shpirtërore, është theksuar në Kur'an në një pjesë që ngre në qiell besimin e tyre edhe kur janë një hap larg mposhtjes në luftë:

Njerëzit thanë: «Vërtet populli (pagan) ka grumbulluar kundër jush një ushtri të madhe, kështu që friksojuni atyre», por kjo në të vërtetë vetëm u shtoi Besimin dhe thanë: « Allahu vetëm na mjafton neve dhe për ne Ai është Rregulluesi më i mirë i punëve. Kështuqë ata u kthyen me Mirësi dhe Begati nga Allahu. Asnjë e keqe nuk i preku dhe ndoqën Kënaqësinë e Allahut dhe Allahu është Zotëruesi dhe Dhuruesi i Mirësive të pafund. Vetëm Shejtani jua shtie në mendje frikën e ndjekësve të tij (mosbesimtarët, paganët, mohuesit e njësisë së Allahut, etj), kështu që mos iu frikësoni atyre aspak, por m'u frikësoni vetëm Mua nëse jeni besimtarë të vërtetë. Dhe le të mos pikëllojnë ty (o Muhammed a.s.) ata të cilët nxitojnë në mohim. Vërtet as dëmin më të vogël nuk do t'i shkaktojnë Allahut. është dëshira e Allahut për të mos u dhënë asnjë pjesë në Botën e përtejme dhe për ta do të ketë ndëshkim të madh.

(Sure Al'Imran: 173-177)

Si përfundim, s'ka mjerim, vështirësi apo brenga në jetën e një besimtari që kërkon aprovimin e Allahut dhe i vëzhgon urdhërat e Tij. Kjo tregohet nga rrjedha e ngjarjeve me të cilat Allahu provon këmbënguljen, durimin dhe përruljen. Këto ngjarje, të para nga jashtë, janë shqetësuese dhe të vështira; por nëse priten me durim dhe bindje, ato bëjnë të shihet më mirë mëshira e Allahut. Veç kësaj, Allahu na informon në Kur'an se Ai nuk e ngarkon dikë më shumë sesa ai mund të durojë.

Allahu nuk e rëndon askënd mbi mundësitë që ai ka.

(Sure el-Bekare: 286).

Allahu nuk e dënon një besimtar që i shërben siç duhet, as në këtë botë dhe as në tjetrën. Përkundrazi, Ai e shpërblen atë gjerësisht në këtë botë dhe përtej.

Dhe kur t'u thuhet të përkushtuarve (ndaj Allahut), «Çfarë ju ka zbritur Zoti juaj?» ata do të përgjigjen: «Të gjitha më të mirat» Për ata që bëjnë mirësi në këtë botë, do të kenë mirësi, ndërsa Banesa e Botës së Fundit do të jetë akoma dhe më e mirë. Vërtet e shkëlqyer do të jetë Banesa e të përkushtuarve. Kopshtet e Begatisë së përjetshme të Xhennetit nën të cilët rrjedhin lumenj, ku ata do të hyjnë, aty ka për ta gjithçka që dëshirojnë. Kështu i shpërblen Allahu të përkushtuarit. (Sure en-Nahl: 30-31)

Si një kujtesë nga Allahu, vuajtja, vështirësia dhe shqetësimi i vijnë atyre që nuk janë në gjendje të arrijnë miratimin e Allahut, që nuk tregojnë bindje absolute ndaj Tij por shohin dëshirat e tyre. Kur besimtarët bëjnë një gabim, ata i konsiderojnë shqetësimet dhe vështirësitë si një pasojë , si një paralajmërim i mëshirshëm nga Allahu. Të kujdesshëm, nxjerrin mësim prej tij, pendohen dhe

përmirësojnë sjelljen e tyre. Kurse jobesimtarët, nuk mësojnë kurrë nga mynxyrat që hasin, prandaj meritojnë vuajtje të përhershme në botën tjetër.

TË NJOHËSH SHPIRTIN

Një pjesë tjetër shumë e rëndësishme e informacionit që na jep Kur’ani për njeriun është «shpirti» i tij (en-nefs). «Shpirti», sipas Kur’anit, d.m.th. «ego» ose «personalitet».

Në Kur’an, Allahu shpjegon dy aspektet e shpirtit: një që nxit shejtanin dhe veprat e ulëta, dhe tjetri që ruhet nga çdo ngulitje e shejtanit. Kur’ani e shpjegon këtë në Suren esh-Shems:

Për shpirtin dhe për Atë i cili e përsosi atë në përmasa; pastaj i tregoi atij çfarë është e gabuar dhe çfarë është e drejtë për të; vërtetë që do të ngadhnjehet ai i cili e pastron vetveten; dhe vërtet që dështon ai i cili e prish vetveten.

(Sure esh-Shems: 7-10).

Pra, siç shihet nga ajetet e mësipërme, e keqja ekziston në shpirtin e çdo njeriu. Megjithatë ai që pastron shpirtin e tij do të ketë shpëtim. Besimtarët nuk i dorëzohen të keqes brenda tyre; ata thjesht e evitojnë atë nën orientimin e frymëzimit të Allahut. Ashtu siç tha Profeti Jusuf (a.s.): «Edhe unë nuk e liroj veten nga faji. Padyshim që uni (nefsi njerëzor) është i prirur drejt së keqes - përveç kur Zoti derdh mëshirën e Tij (mbi atë që do) ...» (Sure Jusuf: 53), që është mënyra e duhur e të menduarit të besimtarit.

Meqë uni «është i prirur drejt se keqes», një besimtar duhet të jetë gjithmonë vigjilent për shpirtin e tij. Ashtu siç tha dhe Profeti Muhammed (s.a.u.s.), «beteja më e madhe është beteja kundër vetes (nefsit)». Shpirti, përherë e tundon njeriun dhe nuk i jep nga kënaqësitë e Allahut. Ndërsa bën këto, ai përpiqet të ofrojë alternativa joshëse. Megjithatë, një besimtar, falë frikës së tij nga Allahu, nuk mashtrohet nga ky aspekt «shtrembërues» i shpirtit. Ai gjithmonë kthehet nga ajo që është e drejtë, për të kaluar një jetë në përputhje me Dëshirën e Allahut. Ky është qëndrimi i një personi të mençur, në kundërshtim me atë të një të marri, siç e thotë dhe Profeti Muhammed (s.a.u.s.): Një person i urtë, i mençur, është ai që mban një orë mbi dëshirat dhe pasionet e trupit të tij, dhe e ruan veten nga ajo që është e dëmshme, dhe përpiqet për atë që do i sjelle përfitime pas vdekjes; dhe një person i marrë është ai që ulet para dëshirave dhe pasioneve të tij dhe pret nga Allahu përmbushjen e dëshirave të kota. (Tirmidhiu)

RUAJTJA NGA IDHUJTARIA

Shumë shkurt, idhujtaria është shoqërimi i qenieve të tjera me Allahun. Duke parë këtë përkufizim, shumë njerëz mund të thonë « Ne nuk i shoqërojmë asgjë Allahut», por ndoshta nuk është kështu. Moskuptimi i tyre i idhujtarisë mund të çojë në këtë thënie. Në fakt, Kur’ani tregon rastin e shumë njerëzve që i shoqërojnë diçka Allahut - d.m.th. janë idhujtarë - por që nuk e pranojnë kurrë këtë situatë:

Dhe ditën kur Ne do t'i mbledhim të gjithë ata së bashku, Ne do t'u themi atyre që Na bashkonin të tjerë në adhurim: «Ku i keni shokët të cilët ju gjithnjë i mbajtët (si të adhuruarit tuaj)?» Në këtë kohë nuk do tu lihet asnjë dredhi por vetëm që të thonë: «Betohemi për Allahun, Zotin tonë se nuk kemi qenë prej atyre që adhuronin të tjerë përveç (e përkrah) Allahut .

(Sure En Aam: 22-23)

Askush nuk duhet të pranojë që është i çliruar kompletësisht nga idhujtaria, por duhet t'i lutet Allahut ta mbajë larg saj. Kjo sepse idhujtaria është mëkat i madh. Kur Profetin Muhammed (s.a.u.s.) e pyetën kush ishte mëkati më i madh, ai u përgjigj «T'i bësh shok Allahut, ndërkohë që Ai të ka krijuar ty». Në Kur'an, Allahu pohon se Ai mund të falë të gjitha gjynahet dhe krimet përveç idhujtarisë:

Padyshim që Allahu nuk fal që Atij t'i vihen shokë në adhurim, por Ai fal përveç kësaj këdo që Ai dëshiron. Dhe kushdo që i vë shok Allahut në adhurim vërtet ai ka shpikur një gjynah të tmerrshëm.

(Sure an-Nisa': 48).

Pika fillestare e idhujtarisë, që është një «mëkat dhe shpifje» shumë e madhe, është t'i përshkruash veçoritë e Allahut një qenieje tjetër, thjesht me mend. Fakti është se, atributet (fuqia, inteligjenca, bukuria e me rradhë) që ne ia përshkruajmë qenieve të tjera nuk i përkasin në të vërtetë atyre; ato janë dhënë nga Allahu për një periudhë kohe të përcaktuar dhe të kufizuar. Duke thënë se këtotribute «i përkasin» qenieve të tjera veç Allahut thjesht do të thotë t'i shohësh ato si zotër. Kjo,

përkufizohet si: t'i bësh qëniet në fjalë shok të Allahut, me fjalë të tjera, të krijosh të barabartë (shokë) me Allahun.

Përsa i përket njëshmërisë së Allahut, Kur'ani thotë:

Thuaj: «Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm, Allahu, Zotëruesi i Vetëmjaftueshëm i çdogjëje. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe s'ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me të.

(Sure el-Ihlas: 1-4)

Siç thuhet në ajetet e mësipërme, Allahu është Furnizuesi i të gjithëve; çdo qenie ka nevojë për Të që të ekzistojë. Asnjë gjë është e barabartë me Të. Nëse ky fakt mohohet dhe njerëzit fillojnë të mendojnë se ndonjë qenie ekziston me vullnetin e saj, pa mbështetjen e Allahut, shfaqet idhujtaria (shirku). Me këto mendime, njeriu harron se çdo gjallesë është nën kontrollin e Allahut. Shfaqet papritur një besim i rremë rreth ekzistencës së ndonjë qenieje, që s'ka nevojë për Allahun. Dhe të besosh që një qenie e tillë mund të ekzistojë bën që njeriu t'i kërkojë ndihmë, të kërkojë aprovimin dhe të pranojë rregullat e tij.

Megjithatë, besimtarët që nuk i bëjnë shok Allahut kthehen vetëm nga Ai pasi ata e dinë se Allahu ka fuqinë mbi çdo gjë. Kjo llogjikë bazë e besimtarëve citohet në Kur'an si më poshtë:

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë.

(Sure el-Fatiha: 4)

Ata që i bëjnë shok Allahut në fakt kthehen drejt qënieve që nuk janë të aftë t'i ndihmojnë ata. Kjo sepse qëniet që ata i marrin si hyjni janë gjithashtu shërbëtorë shëndetligë si ata vetë. Mbi këtë Allahu citon:

A i mveshin e i përshkruajnë ata shokë Allahut ato (gjëra, idhuj, zota) që nuk kanë krijuar kurrë por përkundrazi vetë janë të krijuar? Asnjë ndihmë nuk munden ato t'u japin atyre dhe as vetveten e tyre nuk e ndihmojnë dot aspak. Edhe nëse i thërrisni në udhëzim, ata nuk ju ndjekin dhe nuk jua vënë veshin. Njësoj është për to, si t'u bëni thirrje a të heshtni. Sigurisht se ata që ju i lutni në vend të Allahut, ata vetë janë robër si dhe ju. Thirruni pra atyre dhe le t'u përgjigjen nëse jeni të drejtë.

(Sure al-Araf: 191-194).

Pra, idhujtaria është shpifje dhe mashtrim i madh dhe qëndrim jo i urtë. Kjo përshkruhet në Kur'an si më poshtë:

O njerëz! Është thurur një përngjasim për ju, kështu që dëgjoni mirë: Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mblidheshin të gjithë së bashku për t'ia arritur qëllimit. Dhe nëse miza merr diçka prej tyre, ata nuk do të kenë aspak fuqi për ta çliruar atë prej mizës. Kësisoj, të dobët janë që të dy, edhe lutësi edhe i luturi. Ata nuk e kanë vlerësuar lart Allahun me Lartësinë e Tij të Merituar. Vërtet që Allahu është Fuqiplotë, i Gjithfuqishëm.

(Sure el-Haxh: 73-74)

Idhujtaria shfaqet në forma të ndryshme. Meqë njerëzit marrin qenie të tjera veç Allahut si hyjni, ata kërkojnë aprovimin e tyre, i varin shpresat tek ato dhe i pranojnë gjykimet e tyre si të vërteta. Në këtë mënyrë një njeri i nënshtrohet miliona hyjnive imagjinare. Ai shpreson të gjejë qetësi në këto qenie, të cilat janë po aq të pafuqishme sa ai vetë. Megjithatë, ai që i bën shok Allahut është në një qorrsokak dhe humbja e tij është shumë e madhe. Fakti shihet në Kur'an në vijim:

...Bashimi i të tjerëve në adhurim me Allahun është gabim i madh.

(Sure Lukman: 13)

Akoma duhet thënë se një njeri i tillë gënjen veten. Kjo sepse “Allahu nuk i bën padrejtësi aspak njerëzimit, por njerëzimi i bën padrejtësi vetes së tij” (Sure Junus: 44).

TË ARRISH SHUMË NGA KËNAQSITË E ALLAHUT

Një besimtar është një njeri që është «pastruar» nga idhujtaritë dhe nga format e tjera të injorancës, si të shpresuarit në hyjni imagjinare apo të kërkuarit e aprovimit të tyre duke u bërë kështu vartës i tyre. Ai i shërben vetëm Allahut dhe kërkon vetëm aprovimin e Allahut. Siç e kemi thënë në fillim, ai e bën këtë «duke u përpjekur me të tëra mënyrat e duhura».

Çelësi i «të përpjekurit me të tëra mënyrat e duhura» në rrugën e Allahut është të kërkoksh të arrish atë çfarë e kënaq Allahun më shumë. Përballë zgjedhjeve të ndryshme, të gjitha nga të cilat janë të

lejueshme, një besimtar duhet të zgjedhë atë që e kënaq më tepër Allahun. Kjo mund të përshkruhet shkurt si më poshtë:

Një besimtar duhet të kalojë tërë jetën e tij duke bërë çfarë është «e ligjshme». Kur'ani e thotë qartë cilat veprime janë të jashtëligjshme dhe këto janë në të vërtetë shumë pak në numër. Çdogjë tjetër veç këtyre veprave të paligjshme, është e ligjshme.

Bashkë me këtë, një besimtar duhet të përkujdeset ndaj veprave dhe mendimeve që e kënaqin më tepër Allahun. Në këtë orvatje, atë e udhëheqin urtësia dhe «largpamësia» e tij.

Shembulli i «shpenzimit në rrugën e Allahut» (infak) do ta bëjë këtë koncept më të qartë. Një besimtar është një person që i ka shitur «veten dhe pronën e tij» Allahut. Ai duhet të vërë në përdorim gjithçka që zotëron në mënyrën që e kënaq më tepër Allahun. Megjithatë, ai shpesh mund të përballet me zgjedhje të ndryshme. Supozojmë se ai ka një shumë të konsiderueshme parash me të cilat ai mund të blinte një kostum për veten e tij. Në të vërtetë kjo është një gjë e lejueshme dhe e ligjshme për tu bërë; të jesh i kujdesshëm për paraqitjen e jashtme është sigurisht në përputhje me dëshirën e Allahut. Megjithatë, me këto para mund të bëhen gjëra të tjera që mund ta kënaqin Allahun më tepër. Nëse ia jep ato një nevojtar, Allahu do jetë shumë më i kënaqur. Megjithatë ky është një vendim që merret vetëm nga vetë personi. Duke konsideruar kushtet dhe ambientin ku jeton, ai vendos prioritete duke këshilluar më parë ndërgjegjen e tij.

Një shembull tjetër do e shpjegojë më qartë këtë koncept: Një besimtar është përgjegjës për «të shijuar të mirat dhë të ndalojë të keqen», duke përhapur fenë e Allahut dhe duke mbartur një luftë mbi baza intelektuale kundër tiranëve në botë.

Të përkrahësh këtë përgjegjësi të rëndësishme, është një mënyrë për të fituar kënaqësitë e Allahut. Një përgjegjësi e tillë do të thotë që detyra të caktuara kanë përparësi mbi të tjera. Meqë ka shumë detyra të tilla, nuk do të ishte korrekte t'i jepje përparësi ndonjë pune tjetër edhe pse është e lejueshme dhe e ligjshme. Për shembull, burri është përgjegjës për tu kujdesur për familjen e tij, ai duhet të ofrojë siguri dhe mbështetje për antarët e familjes. Megjithatë, të përdorësh këtë si pretekst për të evituar përgjegjësinë për «të shijuar të mirat dhe të ndalosh të keqen» do të ishte zgjedhje e papërshtatshme për një besimtar.

Në të vërtetë, po ta mendojmë, mund të shohim se «shpirti» (en-nefsi), përfshihet kur njeriu preferon diçka më pak të vlershme në sy të Allahut. Kjo preferencë është pasojë e lënies mënjane të një «pjesë» për shpirtin. Në këtë kuptim, njeriu nuk duhet të drejtohet nga shpirti i tij, por të dalë jashtë kësaj për të arritur pëlqimin e plotë të Allahut. Të mundohesh të arrish miratimin e Allahut me 99 % të përpjekjeve të tua dhe të lësh mënjane 1 % pjesë për shpirtin, mund të mos jetë e pranueshme në sytë e Allahut. Kjo sepse personi në fjalë ka bërë shok shpirtin e tij me Allahun. Një idhujtari e thjeshtë prej 1 % mund t'i bëjë shërbimet e tij të papranueshme. Situata e atyre që i bëjnë shok qenieve e tjera veç Allahut , përshkruhet më poshtë:

Ata caktojnë për Allahun pjesë nga blegtoria të cilat Ai i ka krijuar dhe thonë: "kjo është për Allahun", sipas mendjes së tyre "dhe kjo është për 'shokët' tanë". Por pjesa e shokëve të tyre nuk arrin tek Allahu, ndërsa pjesa e Allahut arrin te 'shokët' e tyre. E poshtër është mënyra si ata gjykojnë!

(Sure En Aam:136)

Nëse një person rrezikon jetën për mbrojtur familjen e tij për ndonjë padrejtësi që i është bërë, por mbetet i pavëmendshëm dhe merret vetëm me punët e tij kur ka shtypje dhe shpifje kundër besimtarëve të tjerë, mund të themi se ai nuk e arrin pëlqimin e Allahut. Një sjellje e tillë tregon anim dhe nënshtrim ndaj shpirtit (nepsit) të tij, që është komplet kundër qëllimit Islam «t'i shërbesh vetëm Allahut». Për më tepër, sipas Kur'anit, të veprosh sipas dëshirave të shpirtit është njësoj si t'i bësh shok Allahut.

A e ke parë ti atë i cili ka zgjedhur si zot të tij dëshirën e vet? A do të ishte ti atëherë rregullues i punëve të tij përmbi të?

(Sure el-Furkan: 43)

Një besimtar nga ana tjetër, e përkushton tërë jetën dhe pasurinë e tij ndaj Allahut. Kjo sjellje superiore e besimtarëve përshkruhet në Kur'an:

Thua: “Sigurisht falja ime, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e Aleminit

(Sure En-Aam: 162)

Sjellja e besimtarëve në luftë, në kohën e Profetit (s.a.u.s.) për të arritur atë që e kënaq më shumë Allahun, tregohet në Kur'an. Përballë dy grupe armiqsh, besimtarët preferuan të luftonin kundër grupit më të dobët. Por ishte dëshira e Allahut që ata të luftonin kundër më të fortit. Këto ngjarje tregohen në ajetet e mëposhtme:

Kur Allahu ju premtoi juve një nga dy grupet duhet të ishte juaji, ju dëshiruat atë të paarmatosurin të ishte i juaji por Allahu donte të përlligjte të vërtetën sipas Fjalës së Tij dhe t'u priste rrënjët mosbesimtarëve. Me qëllim që Ai të bënte që të ngadhënjente e vërteta dhe të asgjësonte të pavërtetën, edhe pse këtë e urrenin dhe ishe e hidhur për mosbesimtarët.

(Sure el-Enfal: 7-8)

Pra, Allahu bëri që besimtarët të përballnin grupin më të fortë duke i drejtuar ata tek diçka me të cilën Ai kënaqej më shumë. Në fund, ata triumfuan me ndihmën e Allahut

Shembulli i mësipërm është një ngjarje e lidhur me kushtet e asaj kohe. Por mbetet fakti se në çdo kohë Muslimanët provohen me ngjarje të ndryshme. Sot, për shembull, Muslimanët duhet të përfshihen në një luftë intelektuale kundër atyre që mohojnë Kur'anin dhe faktet e krijimit si dhe atyre që përpiqen të mbjellin imoralitetin në shoqëri. Muslimanët duhet të përcaktojnë rrugën më të mirë që duhet të ndjekin në këtë luftë që ata kanë marrë përsipër. Por, nëse ndonjëri ka fuqinë për ta mbështetur këtë përgjegjësi dhe merret me probleme jo shumë urgjente vetëm për të kënaqur dëshirat e tij, kjo vetëm do ngjallë pakënaqësinë e Allahut.

Në çdo rast, një prirje e tillë nuk përputhet me drejtimin e duhur të sjelljes të një Muslimani. Ai është dikush i zgjedhur nga Allahu dhe të cilit i është dhuruar besimi; ai është përgjegjës për të zhdukur keqbërjen nga shoqëria, ta zëvendësojë atë me paqe dhe të krijojë një ambient ku secili të jetojë në fenë e Allahut. Ai është përgjegjës të luftojë për ato burra, gra e fëmijë që shtypen dhe që thonë: “Zoti Ynë! Na shpëto nga ky qytet me këtë popull shtypës dhe nxirr për ne një prej Teje, që të na mbrojë, na nxirr për ne një prej Teje, që do të na ndihmojë.” (Sure an-Nisa': 75).

Ky koncept nuk kufizohet vetëm me një luftë intelektuale. Gjatë jetës së tij, një Musliman duhet të mbajë këtë pikpamje, në jetën e përditshme, në adhurimet dhe në të gjitha çështjet që has.

Ndërkohë, ne duhet të mbajmë në mend se shprehja «të bësh çfarë e kënaq më tepër Allahun», përdoret për të kuptuar më mirë konceptin: Të largohesh nga çfarë e kënaq më shumë Allahun dhe të merresh me detyra të një rëndësie dytësore është në fakt mospëlqim nga Allahu. Ajo gjë e vetme që e kënaq më tepër Allahun është, në çdo rrethanë, çdogjë në përputhje me dëshirën e Tij. Me fjalë të tjera, nuk ka zgjidhje të tjera për çfarë e kënaq më shumë Allahun.

Të mos e kërkosh këtë gjë dhe të kënaqesh me pak vjen nga një mungesë pamjeje e botës tjetër. Kjo pamje formohet pasi ndonjëri mendon se e meriton parajsën. Por, asnjë nuk mund të jetë i sigurt për një shpërblim të tillë. Në Kur'an, Allahu paralajmëron edhe vetë Profetin (s.a.u.s.) me ajetin, "...Po të deshte Allahu, Ai mund ta kishte vulosur zemrën tënde..." (Sure esh-Shura:24). Me këtë rast, është e qartë se askujt nuk i garantohet parajsja.

Në çdo rast, një besimtar i sinqertë, siç përshkruhet në Kur'an, s'e mendon kurrë se ai apo ajo patjetër meriton parajsën e të rrëmbëhet nga kjo ndjenjë. Besimtari i vërtetë zakonisht i lutet Allahut me «frikë dhe shpresë» (Sure al-A'raf: 56)

Ata që shmangen nga feja e vërtetë mendojnë se e meritojnë parajsën pasi nuk e kanë frikë Allahun si duhet dhe i marrin për të mira veprat e tyre. Me një llogjikë të kotë, ata thonë; «Ne do na falen gjynahet sido të jetë». Megjithatë, kjo është sjellje e veçantë e atyre që nuk e kanë frikë Allahun ashtu si duhet pasur frikë Ai. Për këtë situatë, Allahu thotë:

Pas tyre vijoi një brez i poshtër, të cilët trashëguan Librin , por që zgjodhën për vete të mirat e kësaj bote mashtruese duke thënë (si shfajësim), “çdo gjë do të na falet neve”. Edhe nëse përsëri kotësi mashtruese të kësaj jete do t’u dilnin përpara, ata përsëri do të kapeshin pas tyre. A nuk ishte besa e Librit që iu mor atyre se nuk do të thoshin asgjë tjetër veçse të vërtetën për Allahun? Ndërkohë ata kanë studiuar çfarë ka në të (Librin e tyre). Por Banesa e Botës së Pastajme është më e mirë për të përkushtuarit. A nuk do të kuptoni pra?

(Sure al-A’raf: 169).

Ka gjithashtu edhe nga ata, të cilëve u janë dhënë të mira materiale në këtë botë, që arrijnë në përfundimin e gabuar se Allahu i do ata dhe si rrjedhim do mirëpreiten në parajsë - edhe pse mbartin dyshimin e ekzistencës së saj. Kur’ani na jep një shembull:

Dhe sillu atyre shembullin e dy vetave: njërit prej tyre Ne i patëm dhënë dy kopshte me vreshta dhe ia patëm rrethuar që të dy me hurma ndërsa ndërmjet tyre patëm vendosur fusha të gjelbëruara bereqeti. Secili prej atyre dy kopshteve jepte prodhimet e tij dhe nuk e humbën aspak begatinë e frutave të tyre; po kështu ne bëmë edhe lumë të gurgullojë mes tyre. Dhe kështu ai pati fruta të bollshëm. I tha shokut të tij gjatë një bisede të rastit me të: "Unë kam më shumë se ti pasuri dhe jam më i fortë e i nderuar ndër njerëz". Dhe shkoi pastaj në kopshtin e tij në gjendje të tillë, i padrejtë për veten e vet. Tha: "Nuk më duket se do të shterojë gjithë kjo ndonjëherë. Edhe nuk mendoj se Ora (çasti i Fundit të botës) do të vijë ndonjëherë dhe vërtet nëse do të sillesha prapë te

Zoti im, sigurisht që do të gjeja më tepër begati se kjo kur të kthehesha tek Ai"

(Sure el-Kehf: 32-36).

Një Musliman, në kundërshtim me njerëzit me këtë mendje, i frikësohen «devijimit pas udhëzimit në rrugën e drejtë». Lutja e besimtarëve në Kur'an, është si më poshtë:

“Zoti ynë! Mos na i lër zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar, dhe na dhuro mëshirë nga Mëshira Jote. Vërtet Ti je Dhuruesi më i madh.

(Sure Al'Imran: 8)

Megjithatë, ia vlen të përmendim se kjo nuk është lloji i frikës që ngjall ankth dhe vështirësi në zemrat e besimtarëve. Përkundrazi, frika nga Allahu e motivon besimtarin të përpiqet më tepër për tu bërë shërbëtor që e meriton të hyjë në Parajsë dhe të sigurohet se ai po e kalon jetën e kësaj bote në mënyrën më të mirë të mundshme. Një Musliman synon të arrijë pëlqimin e Allahut në këtë botë që është dhënë për një kohë të shkurtër. Mendimet e tij përqëndrohen në një moment të vetëm që do vijë së shpejti: ai me siguri do vdesë një ditë dhe do përgjigjet për veprat e tij para Allahut. Kjo do e çojë atë ose në shkatërrim të tmerrshëm, të përjetshëm ose në shpëtim të përjetshëm. Nuk do ishte e urtë të mendoje ndonjë zgjidhje tjetër apo të jesh i pavëmendshëm para një ngjarjeje kaq të madhe.

Për shpëtimin e tij, një besimtar ka përgjegjësinë të kërkojë «çfarë e kënaq më tepër Allahun». Të mos e bëjë këtë do të thotë të jetë i pakujdesshëm ndaj rreziqeve që e presin. Para syve të poshtërimit që do ketë në ferr dhe në prani të Allahut, është thelbësore të kërkojë «atë që e kënaq më tepër Allahun».

Po japim disa shembuj që tregojnë sjelljen që shfaqet para rreziqeve të kësaj bote dhe përpjekjet për t'i përballuar, për të kuptuar më mirë si të arrihet çfarë e kënaq më tepër Allahun.

Supozojmë se je përballë një përmblytjeje gjigante ku niveli i ujit rritet shumë shpejt. Në këtë situatë, do vrapoje për në majë të një ndërtese 10-katëshe për të shpëtuar apo do rrije në katin e 5-të dhe do thojë «Ky vend është aq i lartë sa të më shpëtojë.» ?

Le të supozojmë se ndodhet një ashensor që mund të të çojë në katin e fundit. Ky nuk është falas dhe punon vetëm një herë. Ti ke tamam aq para sa duhen për tu ngjitur. Do t'i jepje të gjithë paratë që ke për të ikur në majë apo do rrije në ndonjë kat më poshtë që mund të përmbytet?

Përsëri, le të supozojmë se po bëhet një festë e madhe në katin e 6-të ku ti je strehuar. Do rrije në festë apo do përpiqeshe të ikje në katin e fundit?

Nje shembull tjetër, supozojmë se shoku yt i ngushtë pëson një atak në zemër dhe ai ose ajo duhet çuar menjëherë tek Urgjenca. Në këtë situatë ti do e ngisje makinën sa më shpejt të mundje apo do ecje ngadalë dhe të thojë «Kaq shpejt mjafton, ai ose ajo duhet të durojë» ?

Siç shihet në shembujt e mësipërm, para rreziqeve, njeriu bëhet vigilent dhe bën të pamundurën për të shpëtuar. Kërcënimi më i madh është ferri. Një nga qëllimet më të rëndësishme të një besimtarit është animi i tij i brendshëm për të evituar këtë rrezik.

Për një moment supozojmë se je në buzë të ferrit, rrotull të cilit njerëzit do mblidhen Ditën e Gjykimit dhe do dëshmojnë për pamjet e tij rrënoqethëse. Nëse shikon ferrin, a nuk do zgjidhje mes shumë alternativave pëlqimin e Allahut?

Kur një person çohet në ferr, ai nuk do ketë më rastin të zgjedhë por vetëm do përgjigjet për veprat e tij. Kështu, duhet vepruar nën këtë dritë. Në të vërtetë, një besimtar gjithmonë vepron kështu duke pasur parasysh afrinë e ferrit dhe se ai, në çdo moment, mund të shkojë në botën

tjetër. Në shumë raste, Kur'ani tërheq vëmendjen tek fakti se çdo pendim në botën tjetër është i kotë. Një nga ajetet më të përshtatshme për këtë është:

Dhe atje ata do të bërtasin: "Zoti ynë! Na nxirr të punojmë mirësi e drejtësi, jo ato që punuam gjithnjë". Ai do tu përgjigjet. " A nuk ju dhamë Ne jetë mjaft të gjatë, saqë kushdo që donte të merrte këshillim, mund ta merrte atë? Edhe këshilluesi ju erdhi. Shijoni pra! Për keqbërësit nuk ka asnjë ndihmë.

(Sure Fatir: 37)

Nga ana tjetër, ashtu sic mundohemi tu rrimë larg rreziqeve, duhet të përpiqemi në mënyrë të ngjashme dhe më shumë akoma për të fituar bekimet. Sigurisht që nuk është e urtë të ndjehesh i kënaqur të kesh më pak në parajsë. Kur ikën nga një ishull plot me ar, a nuk do merrje sa më shumë të mundeshe me vete? Kur vjen koha për të ikur nga kjo botë, një Musliman nuk duhet të ndjejë keqardhje e të thotë «Sa doja të kisha bërë këtë apo atë» ose «Sa do doja të kisha fituar shpërblimet e kryerjes së ndonjë vepre veçanërisht të mirë». Për të evituar këtë situatë, ai duhet të zgjedhë me kujdes atë që e kënaq më tepër Allahun.

Mosbesimtarët përpiqen për këtë jetë që nuk është veç një «kënaqësi kalimtare dhe e shpejtë» (Sure Al'Imran: 197). Ndërsa kjo "kënaqësi" ka një fund të hidhur, Allahu premton pëlqimin e Tij, mëshirën dhe parajsën për besimtarët. Një besimtar që ia dëshiron vetes këto premtime të Allahut, duhet të përpiqet shumë për të arritur çfarë e kënaq më tepër Atë.

ÇELËSI I PËLQIMIT TË ALLAHUT: NDËRGJEGJA

Përballë zgjedhjeve të ndryshme, një besimtar duhet të zgjedhë atë që e kënaq më tepër Allahun. Këtu, ndërgjegja është kriteri kryesor që do ta udhëheqë atë drejt zgjedhjes së duhur. I Dërguari i Allahut, profeti Muhammed (s.a.u.s.) i vuri mjaft rëndësi ndërgjegjes në një bisedë që bëri me një burrë.

Një njeri e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.): «Çfarë është besimi?» Ai i tha: «Kur një vepër e mirë bëhet burim kënaqësie për ty dhe një vepër e keqe burim neveritjeje, atëherë je besimtar». Ai e pyeti përsëri të Dërguarin e Allahut: «Çfarë është mëkati?» Atëherë, Ai tha: «Kur i dorëzohesh diçkaje që të therr ndërgjegjen» (Tirmidhiu).

Një nga ndryshimet kryesore mes një besimtari dhe një jobesimtari është se, ndërsa besimtari mbështet dhe beson ndërgjegjen e tij, jobesimtari do merret vesh me shpirtin e tij i cili të shtyn për vepra të ulëta. Si rrjedhim, një besimtar kujdeset për ndërgjegjen e tij dhe kjo është sjellja e tij natyrale.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë që një besimtar është i paprekshëm ndaj tundimeve të vetvetes. Ashtu si tha dhe Profeti Jusuf (a.s.) “Padyshim që uni është i prirur drejt së keqes” (Sure Jusuf: 53). Sipas kësaj, ajo komandon ato alternativa që janë kundër Dëshirës së Allahut.

Një besimtar i eviton këto mashtrime të shpirtit nëpërmjet ndërgjegjes së tij. Përballë një zgjedhjeje, një besimtar fillimisht priret të pranojë atë që i bie ndërmend e para, që në përgjithësi

është ajo që e kënaq më shumë Allahun. Pastaj ndërhyt vetvetja; ajo përpiqet të bëjë më tërheqëse alternativat e tjera dhe të përpiqet t'i ligjërojë ato. Një besimtar duhet t'i mospërfilli këto përpjekje dhe të lidhet fort me zgjedhjen e parë dhe absolutisht korrekte ku e çoi ndërgjegja e tij.

TË DUASH PËR HIR TË ALLAHUT

Ky është lajmi i mirë (premtim për në parajsë) që Allahu i jep shërbyesve të tij që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Thuaju: “Asnjë shpërblim nuk ju kërkoj për këtë përveç që të jeni të mirë me mua për afërsinë time me ju” Dhe kushdo që fiton një vepër të drejtë mirësie, Ne do t'ia shtojmë të mirën për të. Vërtet që Allahu është gjithnjë Falës i Madh, më i Pari të pranojë e të çmojë.

(Sure esh-Shura: 23).

Një besimtar ia përkushton tërë jetën e tij Allahut. Ai jeton për Allahun, punon për Allahun dhe do për hir të Allahut. «Të duash për hir të Allahut» mund të duket një koncept jo i qartë për dikë që nuk është i njohur mirë me Islamin. Ai që ka ndejtur larg Allahut gjatë jetës së tij dhe, si rrjedhim, nuk e ka njohur Atë, nuk do dijë ta dojë Allahun intuitivisht.

Por, një besimtar që e njeh dhe dëshmon për mëshirën e Allahut ndaj tij, që kupton se ajo që do janë mirësitë e Tij dhe se kësaj mëshire i detyrohet ekzistenca dhe jeta e tij, e do Allahun dhe

përfiton ndjenjën fisnike e të dashurit për hir të Allahut. Në Kur'an, tregohet ndryshimi mes besimtarëve dhe njerëzve të tjerë mbi këtë temë.

Dhe ka prej njerëzve të cilët zgjedhin të tjerë përveç Allahut si shokë e të barabartë. Ata i duan këta të adhuruar të tjerë si Allahun, por ata që besojnë e duan Allahun më shumë se gjithçka tjetër.

(Sure el-Bekare: 165)

D.m.th. ata që i bëjnë shok Allahut dhe të cilët, në mendjen e tyre, ia veshin të tëra atributet e Allahut qënieve të tjera, i duan këto qënie njësoj si duhet të donin Allahun. Kjo është ai lloj dashurie e bazuar mbi idhujtarinë.

Duke ditur se çdogjë i përket Allahut dhe se ekzistenca e çdo qenieje të gjallë është krijim i Allahut, besimtarët e duan Allahun mbi çdogjë. Kjo cilësi e lartë, që është pasojë natyrale e njohjes së Allahut si Qenie Superiore Një dhe e Vetme, e bën besimtarin komplet ndryshe nga njerëzit e tjerë. Kjo gjithashtu, përmendet në një nga thëniet e Profetit (s.a.u.s.).

«Kushdo që ka këto tre gjëra kupton ëmbëlsinë e besimit: nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të dashur tek ai se gjithë të tjerët, nëse ai e do një njeri tjetër vetëm për hir të Allahut, Më të Lartit, dhe nëse ai urren të kthehet në mosbesim ashtu si do urrente të hidhej në zjarr»

Nga ana tjetër ata që i bëjnë shok Allahut nuk e durojnë as përmendjen e Allahut.

...Kur ti përmend Zotin tënd Një e të Vetëm në Kur'an, ata kthejnë shpinën duke ikur me urrejtje.

(Sure el-Isra': 46).

Ia vlen të përmendet se ta përkujtosh Allahun pranë idhujve të tyre, kjo nuk i shqetëson idhujtarët. Llogjika e shprehur këtu: «Ne jemi Muslimanë, por ne mund ta shijojmë ditën tonë» është baza e të menduarit të tyre. Nga ana tjetër, besimtari kupton këtë fakt:

Asgjë (qoftë njeri, send, ngjarje, etj) e ka bukurinë nga vetja. Allahu krijon çdogjë dhe i stolis ato me bukuri. Meqë një person, për shembull, nuk e ka vizatuar dhe formuar vetë fytyrën e tij apo të saj, ajo bukuri i përket Allahut.

Allahu ia jep këtë bukuri njeriut, që e krijoi nga asgjë, për një kohë të shkurtër (meqë ai njeri së shpejti do plakët dhe do vdesë). Vetëm Allahu zotëron fuqinë e rikrijimit të bukurisë në botën tjetër, në një formë akoma më perfekte.

Ashtu si për njerëzit, të gjitha krijesat që meritojnë dashuri janë krijuar dhe «zbukuruar» nga Allahu. Meqë zotëruesi i kësaj bukurie është Allahu, Ai bën që kjo bukuri e këtyre qenieve të zhduket me vdekjen e tyre. Në botën tjetër, të gjitha qeniet do rikrijohen.

Me këtë rast, një besimtar i do të gjitha gjërat që ndesh në këtë botë, duke ditur se ato të gjitha i përkasin Allahut dhe se ai do ta shohë bukurinë e formës së tyre «origjinale» në botën tjetër. Si rrjedhim, dashuria e tij aktuale është për Allahun, i Vetmi që e furnizon atë me çdogjë që ai dëshiron: Ai është Zotëruesi i vërtetë i çdolloj bukurie.

Përkundër konceptit të dashurisë të bazuar mbi besimin në Allahun që shijohet nga besimtarët, dashuria e mosbesimtarëve bazohet mbi idhujtarinë. Në Kur'an, kjo formë dashurie përshkruhet nga fjalët e profetit Ibrahim (a.s.):

Ai tha: “Ju keni zgjedhur për adhurim idhuj në vend të Allahut dhe dashuria mes jush është vetëm në jetën e kësaj bote, por Ditën e Kijametit ju do ta mohoni njeri-tjetrin dhe do ta mallkoni njeri-tjetrin dhe vendbanimi juaj do të jetë Zjarri dhe nuk do të keni ndonjë ndihmues.

(Sure el-Ankebut: 25).

Said Nursi, një nga dijetarët muslimanë më të mëdhenj të shekullit të njëzetë, e krahason këtë formë dashurie me atë të një njeriu që e shikon diellin nëpërmjet një pasqyre që mban në dorë. Nëse pasqyra thyhet dhe drita nuk reflektohet më nëpërmjet saj, njeriu ndjen pikëllim të thellë meqë humbi një burim drite. Megjithatë, ai nuk është aq inteligjent sa të kuptojë që drita nuk lind nga pasqyra. Drita vjen nga dielli, pasqyra vetëm sa e reflekton atë. Një besimtar e shfaq tërë dashurinë e tij për Allahun. Të duash Allahun është të duash qeniet, duke pasur kujdes se ato reflektojnë veçoritë e Allahut dhe se këto veçori në fakt i përkasin Atij, si në rastin e pasqyrave.

Prandaj, një besimtar e tregon dashurinë e tij për Allahun duke dashur besimtarët që i shfaqin veçoritë e Allahut me sjelljen e tyre dhe që tregojnë vlera mjaft të mira morale në sy të Allahut. Kjo formë dashurie nuk varet nga farefisnia, raca apo ndonjë lloj interesi tjetër. Pra, çështja është, të duash ata që duan Allahun. Në Kur'an përshkruhet kjo dashuri mes besimtarëve duke e përngjasuar me dashurinë mes shokëve të Profetit (s.a.u.s.) në kohën e tij:

Dhe ata të cilët para tyre patën shtëpitë e tyre dhe pranuan Besimin,- i duan ata që u shpërngulën tek ata dhe nuk kanë aspak zili në gjokset e tyre për atë që iu dha atyre dhe i parapëlqejnë ata mbi veten e tyre, edhe pse ata vetë kishin nevojë për të. Dhe kushdo që shpëton nga lakmia vetjake, të këtillët do të jenë ngadhnjimtarët.

(Sure el-Hashr: 9)

Kur’ani e qartëson se dashuria mes besimtarëve shpërblehet në mënyrë të veçantë nga Allahu:

Vërtet se ata që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, i Gjithmëshirshmi do të dhurojë dashuri për ta.

(Sure Mejrem: 96).

“O Jahja! Mbahu fort pas Librit të Parë! Dhe ne i dhamë atij Urtësi duke qenë akoma fëmijë. Dhe të dashur ndaj njerëzve si mëshirë nga Ne, të pastër nga gjynahet dhe ai që i drejtë e i devotshëm.

(Sure Mejrem: 12-13).

Besimtarët duan vetëm Allahun dhe ata që besojnë në Të. Për këtë shkak, ata nuk duan asnjë që rebelohen kundër Allahut. Kjo theksohet në ajetet e mëposhtme në Kur’an:

O ju që keni besuar! Mos i bëni armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj miq e shokë duke treguar dashuri ndaj tyre, ndërkohë që ata kanë mohuar çfarë ju ka ardhur juve nga e vërteta dhe kanë dëbuar të Dërguarin dhe vetë ju, vetëm për shkak se besoni për çështjen Time dhe për të fituar kënaqësinë time. Ju tregoni miqësi me ta në fshehtësi ndërkohë që Unë jam i Gjithënjohur për gjithçka që ju fshehni ose shfaqni hapur. Dhe kushdo prej jush që e bën këtë, atëherë ai është i larguar larg nga Udhë e Drejtë.

(Sure el-Mumtahineh: 1)

Ju keni një shembull shumë të mirë të Ibrahimit dhe ndjekësve të tij, kur i thanë njerëzve të tyre, “Vërtet që ne jemi të lirë prej jush dhe prej gjithçka që ju adhuroni në vend të Allahut; ne ju kemi

hedhur poshtë ju dhe ndërmjet nesh ka filluar armiqësi dhe urrejtje përgjithnjë derisa të besoni në Allahun Një e të Vetëm...”

(Sure el-Mumtahineh: 4).

O ju që keni besuar! Mos i merrni për mbrojtës baballarët tuaj dhe vëllezërit tuaj, nëse ata parapëlqejnë mosbesimin mbi Besimin. Dhe kushdo prej jush që vepron kështu, atëherë ai është prej keqbërësve.

(Sure et-Teube: 23).

Ti nuk do të gjesh popull i cili beson në Allahun dhe në Ditën e Fundit, të bëjë miqësi me ata që i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe sikur ata të ishin baballarët e tyre, apo bijt e tyre, apo vëllezërit e tyre, apo të afërmit e tyre.

(Sure el- Muxhadilah: 22)

Ajetet e mësipërme thonë qartë që dashuria e besimtarit është vetëm dashuri për Allahun. Duke vënë mënjatë të gjithë faktorët si farefisnia apo të mira materiale, kjo dashuri i ka rrënjët thellë në besim dhe vlera fisnike. Një besimtar ka dashuri për ata, besimi i të cilëve është i sigurt, dhe jo për ata që kanë famë, para apo pozitë shoqërore, të cilat vetëm në dukje janë të rëndësishme.

Duke i pastruar ndjenjat e dashurisë nga faktorë të tjerë veç «dashurisë për Allahun», një besimtar do më tepër ata që kanë më frikë Allahun dhe që përpiqet më shumë të arrijë pëlqimin e Tij. Sa më shumë veçori të një besimtari të mirë të ketë dikush, aq më shumë do çmohet ai nga

besimtarët e tjerë. Gjithashtu në Kur'an shohim se besimtarët kishin si më të dashurin e tyre Profetin (s.a.u.s.) – i cili është më i afërt me Allahun dhe që kishte më tepër frikë nga Allahu:

Pejgamberi është më afër besimtarëve sesa vetë ata me vetveten.

(Sure el-Ahzab: 6)

Meqë besimtari e kupton dashurinë si të bazuar mbi besimin, ai do ta ndërtojë dhe martesën e tij mbi të njëjtat themele. Edhe në këtë pikë, lind një diferencë e rëndësishme mes besimtarëve dhe jobesimtarëve: shpesh jobesimtarët e bazojnë martesën e tyre mbi përfitimet materiale. Kjo është zakonisht e vërtetë për gratë, që përpiqen të gjejnë një «burrë të kamur» për të pasur një standart të lartë jetese. Për këtë arsye një vajzë e re mund të pranojë lehtësisht të bëhet shoqja e jetës e dikujt për të cilin nuk ndjen asgjë. Kjo është, në fakt, e ngjashme me një marrëveshje tregtare nga e cila përfitojnë të dyja palët. Ndryshimi i vetëm është se kjo marrëveshje duhet të zgjasë tërë jetën.

Shembuj martesash të tilla ka shumë. Ka mjaft të rinj që martohen me persona të pasur, apo të vjetër në moshë apo imoralë, vetëm sepse janë të famshëm ose kanë të mira materiale të shumta.

Martesat e mosbesimtarëve nuk janë gjithmonë të bazuara vetëm mbi të mirat materiale. Ka gjithashtu, shumë të rinj që shikojnë pamjen e jashtme apo tërheqjen fizike tek personi që duan të martojnë. Vajza të tilla martohen me burra që atyre u duken si «kalorës mbi kalin e bardhë».

Por llogjika që fshihet pas këtij këndvështrimi lë mënjanë një fakt kryesor: të gjitha këto veti fizike padyshim që janë të dënuara të zhduken. Të gjithë njerëzit do plaken një ditë. Për më tepër,

Allahu mund t'ia heqë një njeriu pamjen e bukur apo shëndetin në një çast. Me pak fjalë, mjafton një aksident dhe mund të mbetesh i paralizuar, etj. Nën këto kushte, çfarë i mbetet asaj martese?

Çfarë do bënte një grua kur burri i saj , për shembull, qërrohet në një aksident, nëse ajo e kishte marrë për sytë e tij të bukur? Me siguri, vetëm atëherë ajo do kuptonte bazën e paarsyeshme mbi të cilën prehej vendimi i saj më i rëndësishëm.

Një besimtar ka për qëllim parajsën e përhershme në botën tjetër. Në jetën e tij përpiqet të arrijë pëlqimin e Allahut për të përfituar «shpëtim dhe lumturi». Duke i përkushtuar lutjet dhe gjithë jetën e tij Allahut, ai me siguri do t'i përkushtojë edhe martesën e tij Allahut.

Kjo lloj martese është padyshim totalisht ndryshe nga ajo e bazuar në «idhujtari». Këtu, nuk kanë rëndësi paratë, fama apo bukuria. Arsyeja e vetme do jetë pëlqimi i Allahut. Besimtarit të vërtetë do t'i pëlqente të martohej me dikë që do ta «ndihmonte» më tepër për të arritur kënaqsinë e Allahut. Si rrjedhim, ai ose ajo duke u martuar me një njeri të tillë, shfaq një besnikëri të thellë ndaj Allahut dhe është më lart në besim dhe devotshmëri.

Për këtë arsye, shumë gra që jetuan në kohën e Profetit Muhammed (s.a.u.s.), shprehën një dëshirë të madhe për tu martuar me Profetin (s.a.u.s.) Ato që mendonin ndryshe përshkruhen në Kur'an se ato duan «jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj»:

O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua: “Në qoftë se dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani pra! Unë do t'ju siguroj jetesën dhe do t'ju lë të lira me bujari. Por në qoftë se doni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe banesën e Jetës së Pastajme, atëherë vërtet që Allahu ka përgatitur për mirëpunueset nga mesi juaj shpërblim madhështor.

(Sure al-Ahsab: 28-29).

VETITË E BESIMTARËVE

Ai që jeton sipas Kur'anit do t'i dojë ata që jetojnë sipas Kur'anit, pra besimtarët. Në sajë të besimit të tyre tek Allahu, besimtarëve u janë dhuruar disa veti për të cilat ia vlen t'i duash. Një besimtar do t'i kërkojë këto veti edhe tek besimtarët e tjerë dhe duke i parë në to ai do t'i çmojë.

Më poshtë po japim vetitë e dallueshme të besimtarëve të shpjeguara në Kur'an:

Besimtarët i shërbejnë vetëm Allahut. Ata nuk adhurojnë në mendjet e tyre asnjë qenie tjetër përveç Tij.

(Sure el-Fatiha: 1-7; Sure an-Nisa':36)

Ata kanë frikë Allahun. Nuk bëjnë asgjë që Allahu e ka ndaluar apo që është kundër dëshirës së Allahut.

(Sure Al'Imran:102; Sure Ja Sin: 11; Sure et-Tagabun: 16; Sure ez-Zumer: 23)

Ata besojnë vetëm tek Allahu.

(Sure el-Bekare: 249; Sure et-Teube: 25-26)

Kanë frikë vetëm Allahun.

(Sure el- Ahzab: 39)

Ata i janë gjithmonë mirënjohës Allahut. Mirëqenia apo varfëria nuk i bën ata të ndihen të lumtur apo keqardhës për veten e tyre.

(Sure el-Bekare: 172; Sure el-Isra': 3; Sure Ibrahim: 7)

Ata kanë siguri në besimin e tyre. Mendimi që të mos fitojnë pëlqimin e Allahut nuk u vjen kurrë. Ata i kryejnë shërbimet e tyre të palodhur e me zell.

(Sure el-Huxhurat: 15; Sure el-Bekare: 4)

Ata i binden Kur'anit. Ata i drejtojnë veprat e tyre në përputhje me ligjin Kur'anor. Ata e flakin menjëherë një sjellje kur kuptojnë se ajo nuk është në përputhje me mësimet e Kur'anit.

(Sure al-A'raf: 170; Sure el-Ma'ideh: 49; Sure el-Bekare: 121)

Ata e përkujtojnë vazhdimisht Allahun. Ata e dinë se Allahu është Dëgjuesi dhe Shikuesi i çdogjëje, dhe e kanë gjithmonë në mend Fuqinë e Përjetshme të Allahut.

(Sure Al'Imran: 191; Sure er-Ra'd: 28; Sure en-Nur: 37; Sure al-A'raf: 205; Sure el-Ankebut: 45)

Ata e njohin dobësin e tyre para Allahut. Jane të përlurur. (Kjo s'do të thotë se janë të dobët).

(Sure el-Bekare: 286; Sure al-A'raf: 188)

Ata e dinë se nuk do t'u ndodhë asgjë përveç asaj që u ka përcaktuar Allahu. Ata nuk lodhen tepër për diçka e janë gjithmonë të qetë dhe mbështeten tek Allahu.

(Sure et-Teube: 51; Sure et-Tagabun: 11; Sure Junus: 49; Sure el-Hadid: 22)

Qëllimi i tyre kryesor është jeta e përtejme. Ata kanë të mira dhe në këtë botë dhe përpiqen ta përmirësojnë atë.

(Sure an-Nisa':74; Sure Sad: 46; Sure al-A'raf:31-32)

Ata kanë shokë të afërt vetëm Allahun dhe besimtarët.

(Sure al-Ma'ideh: 55-56; Sure el-Muxhadilah: 22)

Ata janë njerëz të kuptueshëm. Nuk e humbin kurrë ndjenjën e devotshmërisë, janë të kujdesshëm dhe vigjilentë në çdo moment. I shërbejnë gjithmonë interesave të besimtarëve dhe të fesë.

(Sure Gafir: 54; Sure ez-Zumer: 18)

Ata përpiqen sa të munden për në rrugën e Allahut. Luftojnë me mosbesimtarët mbi baza intelektuale, sidomos me prijësit e mosbesimit. Nuk ndihen kurrë të zhgënjyer apo të dobët në këtë luftë.

(Sure el-Enfal: 39; Sure el-Haxh: 78; Sure el-Huxhurat: 15; Sure et-Teube: 12)

Nuk ngurrojnë të thonë të vërtetën. Nuk i dëgjojnë talljet dhe sulmet e mospranuesve dhe nuk kanë frikë nga çensura e njerëzve.

(Sure el-Ma'ideh: 54,67; Sure al-A'raf: 2)

Përdorin mënyra të ndryshme për të përcjellë mesazhin e Allahut e të mbledhin njerëz rreth fesë së Allahut.

(Sure Nuh: 5-9)

Ata nuk i shtypin të tjerët. Janë të mëshirshëm dhe zemërbutë.

(Sure en-Nehl: 125; Sure et-Teube: 128; Sure Hud: 75)

Ata nuk rrëmbehen nga zemërimi i tyre; janë tolerantë dhe jofalsë.

(Sure Al'Imran: 134; Sure al-A'raf: 199; Sure esh-Shu'ara': 40-43)

Janë njerëz të besueshëm. I befasojnë njerëzit me personalitetin e tyre të fortë dhe i bëjnë të ndjejnë besueshmërinë e tyre.

(Sure ed-Dukhan: 17-18; Sure et-Tekuir: 19-21; Sure el-Ma'ideh:12; Sure en-Nehl: 120)

Akuzohen si magjistarë apo të çmendur.

(Sure al-A'raf: 132; Sure Junus: 2; Sure Sad: 4; Sure el-Hixhr: 6; Sure el-Kemer: 9)

Mbi ta ushtrohet shtypje.

(Sure esh-Shu'ara: 49,167; Sure el-Ankebut: 24; Sure Ja Sin: 18; Sure Ibrahim: 6; Sure en-Neml: 49,56; Sure Hud: 91)

Ata janë të durueshëm përballë fatkeqësive.

(Sure el-Ankebut: 2-3; Sure el-Bekare: 156, 214; Sure Al'Imran: 142,146,195; Sure el-Ahsab: 48; Sure Muhammed: 31; Sure En'am: 34)

Nuk kanë frikë nga vuajtjet apo vdekja.

(Sure et-Teube: 111; Sure Al'Imran: 156-158, 169-171, 173; Sure esh-Shu'ara: 49-50: 49-50; Sure es-Saffat: 97-99; Sure an-Nisa': 74)

Ata sulmohen dhe përqeshen nga mosbesimtarët.

(Sure el-Bekare: 14,212)

Ata janë nën mbrojtjen e Allahut. Të gjitha intrigat dhe komplotet kundër tyre janë të kota. Allahu i mbron kundër çdo shpifjeje e ngatërrese dhe i lartëson ata.

(Sure Al'Imran: 110-111, 120; Sure Ibrahim: 46; Sure el-Enfal: 30; Sure en-Nehl: 26; Sure Jusuf 34; Sure el-Haxh: 38; Sure el-Ma'ideh: 42,105; Sure an-Nisa': 141)

Ata e trajtojnë Shejtanin dhe ndjekësit e tij si armiq.

(Sure Fatir: 6; Sure ez-Zuhruf: 62; Sure el-Mumtahineh: 1; Sure an-Nisa': 101; Sure el-Ma'ideh: 82)

Ata luftojnë me hipokritët. Nuk mbajnë shoqëri me njerëz që shfaqin vetitë e hipokritëve.

(Sure et-Teube: 83,95,123)

Ata veprojnë duke u këshilluar me njëri-tjetrin.

(Sure esh-Shura: 38)

Ata nuk vuajnë për jetesat e mira të mosbesimtarve.

(Sure el-Kehf: 28; Sure et-Teube: 55; Sure Ta Ha:131)

Atyre nuk u bëjnë përshtypje të mirat materiale apo gjendja shoqërore.

(Sure el-Haxh: 41; Sure el-Kasas: 79-80; Sure en-Nehl: 123)

Ata e kryejnë çdo vepër devotshmërie në mënyrën më të mirë.

(Sure el-Bekare: 238; Sure el-Enfal:3; Sure el-Mu'minun: 1-2)

Ata nuk ndjekin turmën por vetëm kriterin e parashtruar nga Allahu.

(Sure En'am: 116)

Ata përpiqen të afrohen sa më shumë tek Allahu dhe të shërbejnë si shembuj për ata që besojnë.

(Sure el-Ma'idëh: 35; Sure Fatir: 32; Sure Vaki'a: 10-14; Sure el-Furkan: 74)

Ata nuk ndikohen nga Shejtani.

(Sure al-A'raf: 201; Sure el-Hixhr: 39-42; Sure en-Nehl: 98-99).

Ata nuk ndjekin verbërisht baballarët e tyre. Sillen në përputhje me mësimet Kur'anore.

(Sure Ibrahim: 10; Sure Hud: 62,109)

Nuk lejojnë keqtrajtimin e grave.

(Sure en-Nur: 4; Sure et-Talak: 6; Sure el-Bekare: 231, 241; Sure an-Nisa': 19)

Evitojnë tepritë.

(Sure En'am: 141; Sure el-Furkan: 67)

Ata ruajnë moralin dhe martesën e tyre dhe e kalojnë jetën martesore ashtu si dëshiron Allahu.

(Sure el-Mu'minin: 5-6; Sure en-Nur: 3,26,30; Sure el-Bekare: 221; Sure el-Ma'idëh: 5; Sure el-Mumtahineh: 10)

Janë modest në praktikimin e detyrimeve të tyre.

(Sure el-Bekare: 143; Sure an-Nisa': 171)

Janë vetëmohues.

(Sure al-Insan: 8; Sure Al'Imran: 92, 134; Sure et-Teube: 92)

Jan të kujdesshëm ndaj pastërsisë.

(Sure el-Bekare: 125, 168; Sure el-Muddethir: 1-5)

Ata i venë rëndësi estetikës dhe artit.

(Sure Saba': 13; Sure en-Neml: 44)

Ata nuk spiunojnë apo shpifin për besimtarët e tjerë.

(Sure el-Huxhurat: 12)

Ata evitojnë xhelozinë.

(Sure an-Nisa': 128)

Ata kërkojnë falje nga Allahu.

(Sure el-Bekare: 286; Sure Al'Imran: 16-17, 147, 193; Sure el-Hashr: 10; Sure Nuh: 28)

SHTYPJA KUNDËR BESIMTARËVE

Veçoritë e besimtarëve të thëna më lart janë dy llojesh:

Në llojin e parë janë ato veçori që besimtarët e shfaqin me vullnetin e tyre; t'i shërbesh Allahut, vetë-sakrifikimi dhe modestia janë disa prej tyre.

Në llojin e dytë janë ato që shfaqin jashtë kontrollit të tyre, p.sh. komplotet kundra tyre apo ngacmimet e mosbesimtarëve. Këto janë shumë të rëndësishme në dallimin e besimtarëve të sinqertë. Kjo sepse shumë nga veçoritë e treguara janë të një natyre të imitueshme. Supozojmë, një hipokrit mund të kryejë çdo akt devotshmërie apo të bëjë sakrificë, nëse ai përfiton nga kjo. Por veçoritë e shfaqura në situata jashtë kontrollit të tyre, janë «të paimitueshme», p.sh. kur mosbesimtarët përpiqen të shtypin besimtarët e sinqertë.

Me këtë rast, këto veçori kanë rëndësi të veçantë në vlerësimin e besimtarëve. Për të kuptuar nëse një popull përbëhet nga besimtarë të sinqertë, duhet të merren në konsideratë ligjet e pandryshueshme të Allahut të shpjeguara në Kur'an.

Ndërsa numërohen poshtërimet dhe mashtrimet kundër Muslimanëve, ne duhet të kemi parasysh ngjarjet në të cilat u ndodhën dhe Muslimanët e parë:

Apo mendoni se do të hyni në Xhenet pa sprovime të atilla të cilat u erdhën dhe atyre të cilët kanë kaluar para jush?

(Sure el-Bekare: 214).

Në ajetin ku theksohet “prova të atilla të cilat kanë kaluar para jush”, arrijmë në një pikë kyçe . Armiqtë e profetëve dhe besimtarëve nuk thonin : «Këta njerëz besojnë tek Allahu dhe kërkojnë pëlqimin e Tij» ose «Këta njerëz nuk janë imoralë si ne, ata kanë vlera të larta». Përkundrazi, ata përpiqen të mashtrojnë besimtarët dhe t’i akuzojnë ata në mënyra të ndryshme.

Padyshim, ata nuk do guxonin të thonin «Ne jemi rebelë kundër Allahut dhe ne nuk njohim kufij të moralit; ne vetëm duam të nënshtrojmë këta njerëz që nuk na shërbejnë ne». Nuk do të ishte e urtë të prisje rrëfime të tilla nga këta njerëz, si: «Këta janë njerëzit që ndjekin urdhërat e Allahut, kurse ne jemi armiq». Përkundrazi, ata do të përpiqeshin të fuqizonin mashtrimet e tyre duke i paraqitur besimtarët si negativë dhe vetveten si njerëz «të sjellshëm dhe të ndershëm». Në ngjarjet e përshkruara në Kur’an, shohim të përdoret e njëjta metodë kundër besimtarëve të së kaluarës.

Për shembull, Profeti Nuh (as) - si të gjithë profetët e tjerë - i thërriste njerëzit e tij t’i shërbenin vetëm Allahut. Një sistem i bazuar mbi shërbesën vetëm ndaj Allahut padyshim që pengonte rritjen e interesave të krerëve të shoqërisë, të cilët kërkonin të mira materiale dhe rang të lartë shoqëror. Padyshim që, këta krerë nuk do pranonin të thonin se ajo që kërkonte Nuhu (as) ishte kundër interesit të tyre. Përkundrazi, ata e akuzonin se ishte ai që kërkonte interesat e tij - «gjendje dhe prestigj». Kur’ani jep një pamje të kësaj situate si më poshtë:

Dhe sigurisht që Ne e dërguam Nuhun te populli tij dhe u tha: “O populli im! Adhuroni Allahun! Ju s’keni të adhuroar veç Tij. A nuk frikësoheni pra? “Por prijësit e mosbesimtarëve nga populli i tij thanë: “Ai nuk është më tepër veçse një njeri si dhe ju që kërkon të bëhet sundues mbi ju...”

(Sure el-Mu’minun: 23-24).

Profeti Musa (as) dhe Profeti Harun (as) u akuzuan për të njëjtën gjë. Faraonin dhe rrethi i ngushtë i tij u thanë: “A ke ardhur te ne që të na largosh nga ai besim të cilin i gjetëm baballarët tanë ta ndjekim dhe që ju të dy të mund të keni madhështi në tokë? Ne nuk do t’ju besojmë ju të dyve” (Sure Junus: 78).

Mashtrimet e bëra kundër besimtarëve mund të arrijnë një shkallë të paimagjinueshme. Përgjatë historisë, të dërguarit e Allahut janë akuzuar se i « magjepsnin dhe hutonin» besimtarët rreth tyre.

Ata thanë: “Vërtet që këta të dy janë dy magjistarë. Qëllimi i tyre është t’ju nxjerrin ju nga toka juaj me magji dhe të mënjanojnë e të mundin prijësit e të parët tuaj”.

(Sure Ta Ha: 63).

Dhe mosbesimtarët thonë: “Ky është magjistar, gënjeshtar”.

(Sure Sad: 4)

Ambicia kryesore e atyre që përgojnë Muslimanët është që t’i paraqesin si një imazh që ka të njëjtat vese që shfaq vetja e tyre. Ata shkuan aq thellë me këtë sa guxuan t’i thonë Profetit Nuh (as) “gënjeshtar i pafytyrë” (Sure el-Kamer: 25).

Një shpifje tjetër mjaft e shpeshtë kundër besimtarëve është ajo e «çmendurisë». Në fakt, kjo shpifje vjen nga paaftësia e kuptimit të një llogjike baze shumë të rëndësishme të besimtarëve. Duke mos patur konceptin e «fitimit të kënaqësisë së Allahut», mosbesimtarët e kanë të vështirë të kuptojnë veprimet e besimtarëve të cilat drejtohen nga ky qëllim i vetëm. Ata nuk e kuptojnë dot pse besimtarët , që padyshim nuk ndjekin interesat për shërbimet që kryejnë, i përkushtojnë

jetën e tyre Allahut. Në sytë e tyre, kjo sjellje idealistike nuk mund të jetë gjë tjetër veç «çmenduri».

Përgjatë historisë, ata shpesh janë akuzuar për këtë. Për Profetin Musa (as) Faraoni tha: “Vërtet që i Dërguari juaj që është sjellë tek ju është një i çmendur. (Sure esh-Shu’ara: 27). Gjithashtu, kur mohuan Profetin Nuh (a.s.), njerëzit e tij i thanë: “I çmendur”. (Sure el-Kamer: 9).

Përveç këtyre, besimtarët janë akuzuar gjithashtu edhe për marrëdhënie të jashtligjshme. Profeti Jusuf (as) dhe Mejreme (as), modelë për tu ndjekur nga të gjithë burrat dhe gratë besnikë, janë njerëz të fismë mbi të cilët ra kjo akuzë.

Më tepër akoma, mosbesimtarët akuzuan shumë profetë si “në gabim të qartë” (Sure al-A’raf: 60).

Por nuk do të ishim korrektë të thonim që këto ngjarje i përkasin të kaluarës. Kur’ani na informon se besimtarë të tjerë mund të kenë të njëjtat eksperiencë. Prandaj, çdo besimtar që mbron fenë e vërtetë, d.m.th. që shqetëson ata që janë larg vlerave të atij besimi, mund të jetë gjithmonë prë e akuzave dhe mashtrimeve të tilla.

Duhet të kujtojmë se ajo që mosbesimtarët përhapin për Muslimanët mund të jetë pjesë e kësaj fushate shpifjesh. Ashtu siç këshillon dhe Kur’ani, para hetimeve, ne duhet të evitojmë këto lajme të shpërndara nga «devijuesit». Për këtë, Allahu na paralajmëron:

O ju që keni besuar! Në qoftë se një njeri i lig e i poshtër ju vjen juve me ndonjë lajm, sqaroheni e bëjeni të qartë, që të mos dëmtoni njerëzit nga padija dhe pastaj të ndjeni keqardhje për çfarë bëtë.

(Sure el-Huxhurat: 6)

JETA NË SHOQËRINË E PADITUR

Në temat e mëparshme, përmendëm që ndryshimi kryesor mes mosbesimtarëve dhe besimtarëve është njohja e fuqisë të pafundme të Allahut nga këta të fundit. Gjithashtu folëm se si një besimtar, që njih ekzistencën e Allahut, duhet ta orientojë gjithë jetën e tij për të fituar pëlqimin e Allahut.

Një nga karakteristikat e këtij personi është se ai e çliron veten nga të gjitha qeniet e tjera përveç Allahut. Duke pasur jetën të përqendruar në arritjen e pëlqimit të Tij dhe duke qenë shërbyes ndaj Tij, ai zhvillon një këndvështrim tjetër të universit, i cili ai e di se është krijuar dhe kontrolluar nga Allahu. Meqë ai e konsideron Allahun si hyjni të vetme, hyjnitë fallso rreth tij humbin çdo kuptim.

Në Kur'an, kjo temë theksohet në historinë e Profetit Ibrahim (as) e shpallur Profetit Muhammed (s.a.u.s.):

...Ai ishte njeri i së vërtetës, Pejgamber. Kujto kur i tha babait t tij: “O babai im! Pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh dhe nuk të sjell dobi për asgjë?”

(Sure Mejrem: 41-42)

Meqë besimtari kërkon pëlqimin vetëm të Allahut, i lutet Atij dhe i kërkon mëshirë vetëm Atij, ai është bërë «i pavarur» nga krijesat e tjera. Ai nuk ka nevojë të kërkojë pëlqimin e njerëzve të tjerë dhe nuk i var shpresat tek askush tjetër veç Allahut. Fitimi i lirisë së vërtetë është në fakt, i mundur nëse kuptohet ky dhe kthehet drejt Allahut.

Jetët e atyre ku mungon besimi i vërtetë, ndryshe nga ato të besimtarëve, i nënshtrohen hyjnive fallso, të panumërta. Njerëz të tillë, përkushtojnë tërë jetën e tyre për të fituar pëlqimin e shumë të tjerëve, dhe kur kanë nevojë për ndihmë ia kërkojnë prapë njerëzve. Në të vërtetë, krijesat që mosbesimtari hyjnizon në mendjen e tij nuk janë gjë tjetër veç «shërbyes» të dobët, si ai vetë. Këto qenie janë shumë larg aftësisë së përmbushjes të dëshiravë të tij, e aq më tepër shpëtimit të tij. Vdekja është, padyshim, fakti më evident që tregon se këto qenie të hyjnizuara janë të pafuqishme. Megjithatë, do të ishte shumë vonë të prisje vdekjen për të kuptuar natyrën imagjinare të këtyre qenieve. Kjo tregohet në Kuran, si më poshtë:

Dhe kanë marrë në vend të Allahut të adhuruar të tjerë duke shpresuar se mund të ndihmohen. Ata nuk mund t'u sjellin ndihmë atyre, por do të sillen si turmë kundër atyre të cilët i patën adhuruar.

(Sure Ja Sin: 74-75).

Mosbesimtarët e bazojnë jetën e tyre mbi këtë arsye mjaft të shtrembër. Këtu del në pah një ndryshim tjetër kryesor mes besimtarëve dhe mosbesimtarëve: Besimtarët e pranojnë kushtin e zbritur nga Allahu, si udhërrefyesin e tyre të vetëm. Ata vëzhgojnë urdhërat e Kur'anit, vetëm Librin dhe Sunnetin e Profetit (s.a.u.s.). Feja e tyre është Islami, i cili është i shpjeguar në detaje në Kur'an dhe na është treguar nëpërmjet jetës shembullore të Profetit (s.a.u.s.)

Njerëzit që jetojnë të papërqëndruar ndaj Allahut me siguri do pranojnë kushtet e parashtruara nga hyjnitë imagjinare sesa kushtin e vënë përpara nga Allahu.

Ndryshe nga Islami (ligji i vetëm dhe i pandryshueshëm i Allahut), feja e tyre është politeiste. Këta njerëz kanë rregulla të shumta të paqarta dhe qëllime të imponuara nga shoqëria. Kështu, fetë politeiste që ata ndjekin mund të marrin forma të ndryshme.

Disa prej tyre synojnë të paratë dhe pushteti, ndërsa të tjerët dëshirojnë një gjëndje të lartë dhe prestigjioze shoqërore. Disa shpresojnë të gjejnë një «grua të mirë» dhe të kenë një «jetë të lumtur familjare». Kjo shumëllojshmëri mënyrash të ndryshme jetese dhe si rrjedhim shumëllojshmëri «besimesh fetare», vjen nga mungesa e kuptimit të ekzistencës të Allahut dhe kufijve të Tij.

Megjithatë, njeriu ka prirje të besojë Allahun dhe të jetë shërbyes i Tij. I paaftë të përmbushë nevojat dhe dëshirat e tij të panumërta vetë, ai prirret të kthehet vetëm drejt Allahut. Pra, natyra njerëzore anon drejt njohjes së Allahut si Zot i saj:

Kështu drejto ti fytyrën tënde drejt Besimit të Pastër Islam në një Zot të vetëm me të cilin Ai ka krijuar njerëzimin. Le të mos ketë asnjë ndryshim në Rrugën e Allahut. Kjo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë.

(Sure er-Rum: 30)

Një besimtar i sinqertë që nuk tundohet nga dëshirat e këqija të shpirtit të tij por që beson në Allahun, mëson si ta drejtojë jetën e tij nëpërmjet librit të shpallur nga Allahu dhe ndjek profetët si modelë të tij. Jeta e një besimtari është komplet ndryshe nga ajo e një mosbesimtari. Përveç kësaj, nga Kur'ani dhe sunneti i Profetit (s.a.u.s.) një besimtar mëson gjëra ndaj të cilave mosbesimtarët janë krejtësisht të shkujdesur. Për shembull, Allahu ka dhënë lajmin e mirë se çdokush që përmbush detyrimet e Allahut, do ketë shpëtim:

...Kushdo që ka frikë Allahun dhe përmbush detyrimin ndaj Tij, Ai do të sjellë rrugë për të për të dalë (nga vështirësitë). Dhe Ai do t'i sjellë atij Risk prej nga ai as nuk mund ta mendonte. Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, atëherë Ai do t'i mjaftojë atij plotësisht. Padyshim që Allahu do t'ia përmbushë qëllimin atij. Sigurisht që Allahu ka vendosur masë për çdogjë.

(Sure et-Talak: 2-3)

Një besimtar që njih siç duhet fuqinë e Allahut, do t'i përkushtojë jetën e tij, pasi Allahu i mjafton. Kjo shprehet në ajetin e mëposhtëm Kur'anor:

Ai (Jakubi) tha: “O bijtë e mi!...jo se unë mund t'u sjell juve ndonjë përfitim përkundër Allahut. Vërtetë që gjykimi është vetëm i Allahut; tek Ai unë e kam lidhur besimin dhe ata që kërkojnë mbështetje, le të mbështeten vetëm tek Ai.

(Sure Jusuf: 67)

Një besimtar që e kupton drejt këtë fakt do shikojë që detyra e tij në këtë botë është të përmbushë urdhrat e Allahut. Ky është dhe «profesioni» i tij. Ai është thjesht përgjegjes të përpiket në rrugën e Allahut. Ai i kërkon Allahut çdogjë, sepse vetëm Allahu mund t'i japë atij çdogjë. Arsyeya e krijimit të njerëzve është e cituar në Kur'an:

Dhe Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhinët vetëm për të më adhuruar vetëm Mua. Dhe nuk dua prej tyre ndonjë furnizim dhe as nuk dua që ata të më ushqejnë Mua. Vërtetë që Allahu, Ai është padyshim Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, i Përhershmi më i Fortë.

(Sure edh-Dhariijat: 56-58)

Prandaj, është e pamundur që një besimtar, që shfaq vlerat morale të theksuara në Kur'an, të mund të ketë «frikë për të ardhmen» e tij. Kjo frikë është veçanti e atyre që e perceptojnë jetën si një përleshje ndërmjet miliona hyjnive të rreme. Duke mos ditur se të gjitha ngjarjet ndodhin nën kontrollin e Allahut dhe duke besuar tek fati, ata mendojnë se duhet të luftojnë për të mbijetuar. Mendojnë se do përfitojnë po të «shkelin mbi të tjerët» dhe të «abuzojnë me ta» për të arritur qëllimet dhe interesat e tyre. Në të vërtetë, mendimi i tyre përputhet me atë që marrin...

Said Nursi shpjegon se si njeriu nuk kupton që detyra e tij e vërtetë është të jetë shërbyes i Allahut dhe gjithashtu shton:

«... Ata më kot nxorrën përfundimin se jeta është një betejë.»

Kjo llogjikë, e atyre që nuk jetojnë në përputhje me vlerat morale të Kur'anit, është një nga dogmat bazë të besimit të tyre.

Është për shkak të kësaj llogjike në fjalë që këta njerëz ndjejnë gjithmonë vuajtje dhe tensione:

Shumica e këtyre njerëzve, ndryshe nga besimtarët, janë egoistë që shqetësohen vetëm për përfitimet e tyre.

Dashuria e tyre bazohet në arritjen e avantazheve; duan një njeri sepse kjo është në interesin e tyre dhe jo për vlerat apo vetitë e tyre të mira.

Edhe ata që i konsiderojnë si të dashurit e tyre, afrohen për të njëjtat arsye, duke krijuar kështu një shoqëri të pandershme. Ata gjithmonë ndjejnë brengën e mosbesnikërisë të partnerëve të tyre, meqë e dinë se ata në çdo kohë mund të gjejnë të tjerë më të pasur apo më të bukur...

Ata vuajnë nga xhelozia, gjë që i pengon ata të shijojnë të bukurën dhe të mirat. Për shembull, në vend që t'i kënaqet syri me bukurinë e dikujt dhe të thonë «Sa bukur e ka krijuar Allahu», ata ndihen jo të qetë dhe pyesin, «Pse nuk jam dhe unë aq i bukur sa ai apo ajo?»

Ata nuk i janë mirënjohës Allahut ose janë të pakënaqur me të mirat e tyre. Në këtë situatë, ata duan të kenë sa më shumë. Kjo dëshirë e pashtershme bëhet burim i vazhdueshëm turbullirash.

Të pazotë për të kuptuar dobësinë e tyre, ata nuk i kërkojnë ndihmë Allahut. Mendojnë se do shpëtojnë nga dobësitë e tyre nëse i kthejnë kurrizin Allahut me kryelartësi pa i kërkuar ndihmë Atij. Por, nuk është vetëm kjo zgjidhja e tyre. Në këtë kohë, ata i drejtohen të tjerëve dhe i varin shpresat tek ata, të cilët nga ana e tyre janë individë të dobët që mendojnë për veten e tyre. Për më tepër, ata s'mund të jenë mëshirëplotë. Për këtë arsye ata shpesh ndihen «të depresionuar» pasi nuk kënaqin dot parashikimet e tyre.

Atyre u mungon falja dhe toleranca. Për këtë, edhe mospajtimi më i vogël mund të shpërthejë në konflikt të vërtetë. Dhe, secila palë ndjen krenari të pranojë se ka bërë gabim. Prandaj, shpesh ndihen të përvuajtur.

Ata, nuk besojnë se jetojnë nën kontrollin dhe mbrojtjen e Allahut, por në një xhungël të pamëshirshme ku u duhet të «mundin» të tjerët, për të mbijetuar. Në bazë të kësaj ideje, ata mundohen të krijojnë një karakter të ashpër, agresiv dhe egoist për të mbijetuar në këtë «xhungël». Në të vërtetë, sjellja e tyre përputhet me atë që i pret. Kështu, ata gëlltiten, si në shembullin e «peshkut të vogël», ose bëhen «peshq të mëdhenj» dhe gëlltisnin të tjerët.

Këto ligje aplikohen pothuajse në të gjitha shoqëritë ku njerëzit nuk praktikojnë fenë e vërtetë por sillen sipas moraleve të gabuara të përshkruara më lart. Kur’ani i quan këto shoqëri “mohuese dhe të paditura” pasi ato janë komplet të shkujesura ndaj Allahut dhe botës tjetër.

Kur’ani na tregon se Profeti Musa (a.s.) i përshkruan bijtë e Izraelit, një turmë njerëzish që nuk treguan asnjëherë urtësi apo nënshtrim ndaj Allahut, si mohues:

Dhe Ne i sollëm të sigurtë Bijt e Izraelit përmes detit derisa arritën te një popull i dhënë në adhurimin e idhujve. Ata thanë: “O Musa! Na bëj dhe ne një Zot siç kanë edhe këta zotat e tyre.” Ai u tha: “Vërtet që ju jeni një komb që nuk dini. Padyshim që këta njerëz do të shkatërrohen për çfarë po veprojnë dhe e gjitha kjo që po veprojnë është krejt boshe dhe e kotë”. Ai tha: “A të kërkoj për ju të adhuruar tjetër përveç Allahut, ndërkohë që Ai ju ka zgjedhur ju përmbi gjithë Alemin?”

(Sure al-A’raf: 138-140)

Megjithatë, ashtu si e thamë më parë, «shoqëria e paditurisë» nuk është uniforme. Mund të ketë pjesë të ndryshme në një shoqëri, të cilat shfaqin karakteristika të ndryshme. Zakonisht shoqëria segmentohet në bazë të shkallës së arritjes së kriterëve - përgjithësisht, fuqia ekonomike - të vendosur nga vetë shoqëria.

KRITERET E VLERËSIMIT TË NJERËZVE NË SHOQËRINË E «PADITUR».

Muslimanët pranojnë «takua'-në» (respekti apo frika ndaj Allahut që frymëzon secilin për tu ruajtur nga veprat e ulëta) si kriteri i vetëm me të cilin të vlerësojnë njerëzit. Siç thotë dhe Profeti (s.a.u.s.), ata e dinë se «njeriu më perfekt në besimin e tij mes besimtarëve është ai, sjellja e të cilit është më e përsosur». (Tirmidhiu). Në shoqëritë mohuese (injorante), të përbëra nga njerëz të pafé, kriteri kryesor, me të cilin të vlerësosh të tjerët, është «paraja»: Meqë ra fjala, shfaqen dhe shumë baza llogjike të gabuara në këto shoqëri:

Një person i pasur, edhe pse i pandershëm dhe i korruptuar, gëzon respekt.

Sipas këtij rregulli të përcaktuar nga shoqëria, kush është «i pasur por i pandershëm» beson se është një person i «respektueshëm»

Meqë shoqëria i jep kaq rëndësi «parave», i varfri do ndjejë më pak vetëbesim. Ky qëndrim i të varfërve bëhet më i dukshëm kur ata rrinë mes të pasurve. Një njeri i varfër mund të ndihet fare mirë më superior ndaj të pasurit pranë tij pasi ky i fundit është i shthurur. Megjithatë, nën ndikimin e ideve të shtëna nga shoqëria, ai nuk arrin ta mundë ndjenjën e tij të mospërshtatjes.

Në shoqërinë e injorancës, ku zotërimi i «parave» është kushti kryesor, mbizotëron degjenerimi moral. Një shthurje e tillë shfaqet në forma të ndryshme, si rryshfetet, abuzimi i autoritetit, falsifikimi, etj, dhe është e përzier pothuajse totalisht në jetën e përditshme. Për këtë, janë të

ligjshme të gjitha metodat, sado imorale apo të padrejta qofshin, për të bërë parà. Historia e Karunit në Kur'an e shpjegon këtë aspekt:

Vërtetë që Karuni ishte prej popullit të Musait, por ai u soll me kryeneçësi ndaj tyre. Dhe Ne i dhamë atij gjithë thesaret e begatitë, aq sa çelësat ishin një peshë e madhe për t'u mbajtur për një grup të madh burrash të fortë. Kur populli i tij i tha atij: “Mos u ngazëlle. Vërtetë që Allahu nuk i do ata që ngazëllehen. Por kërko me atë që Allahu ta ka dhuruar , Botën e Pastajme dhe mos e harro edhe pjesën e lejuar të kënaqsisë së kësaj bote, edhe bëj mirësi siç ka qenë Allahu i Mirë me ty dhe mos kërko rast për të bërë padrejtësi e djallëzi në tokë. Vërtetë që Allahu nuk i do të padrejtët.” Ai tha: “Kjo më është dhënë mua vetëm për shkak të diturisë që kam unë.” A nuk e dinte ai se Allahu ka shkatërruar para tij breza të tërë, njerëz më të fuqishëm se ai dhe me pasuri të mbledhur akoma më të madhe? Por keqbërësit as që do të pyeten për mëkatet e tyre. Kështu ai doli para popullit të tij me kryelartësinë e tij. Thanë ata që ishin të dëshiruar për jetën e kësaj bote: “Ah, sikur edhe ne të kishim ashtu siç i është dhënë Karunit! Vërtetë që ai ka në dorë një fat të madh!” Po ata të cilëve u ishte dhuruar dija thanë: “Mjerë për ju! Shpërblimi i Allahut është tejet më i mirë për ata të cilët besojnë dhe që punojnë mirësi e drejtësi dhe këtë askush nuk do ta arrijë përveç atyre që janë të duruar”. Kësisoj Ne e bëmë atë që ta përpijë toka bashkë me shtëpinë e tij. Pastaj ai nuk pati asnjë grusht njerëzish ta ndihmonin atë përkundër Allahut, as nuk ishte prej atyre që mund të shpëtojnë vetveten. Dhe ata që kishin dëshiruar për një pozitë të atillë si e tij një ditë më parë, filluan të thonë: “A nuk e dini se është Allahu Ai i Cili shton Riskun ose e pakëson atë për kë ai do nga robt e Tij? Po të mos kishte qenë Allahu i Mëshirshëm ndaj nesh, Ai do ta kishte bërë tokën të na gëlltiste edhe ne të gjithëve! A nuk e dini ju se mosbesimtarët nuk do të jenë kurrë të fituar?!” Banesën e Jetës së Fundit Ne do ta paracaktojmë për ata të cilët nuk

kundërshtojnë të vërtetën me krenari dhe shtypje në tokë dhe që nuk bëjnë as poshtërsi e as krime. Dhe fundi i mirë është për të përkushtuarit ndaj Allahut.

(Sure el-Kasas: 76-83)

Si mund të kuptohet nga ajetet, Karuni dhe ata që e kishin zili ishin pjesë e një shoqërie tipike të injorancës. Ata nuk arritën të kuptonin se Allahu është Zotëruesi i gjithçkaje dhe se Allahu i jep pozita atij që do. Karuni mendonte se, pasuria që kishte i ishte dhënë meqë ishte superior ndaj të tjerëve, gjë që s'ishte e vërtetë.

Meqë Allahu është krijues i çdo gjallese, Ai është Pronari i vërtetë i çdogjije. Kështu, ai që zotëron diçka, mund të konsiderohet si «njeri i besuar», që përkohësisht ka një pronë, e cila në fakt i takon Allahut.

Të mirat, i jepen njerëzve, jo sepse ata janë superiorë apo sepse kanë ndonjë gjë të veçantë. Ato i jepen njeriut si një favor apo si provë. Nga kjo, pritet që ai të mos jetë «arrogant», por «mirënjohës» ndaj Allahut. Nëse dikush nuk e kupton këtë, pasuria që ka nuk i sjell as shpëtim e as lumturi, si në këtë botë ashtu dhe në tjetrën.

Pasuritë nuk jepen që njeriu t'i grumbullojë ato e të bëhet dorështrënguar. Allahu i jep, në mënyrë që njeriu t'i shpenzojë në rrugën e Tij. Përfundimi i atyre që nuk bëjnë këtë, përshkruhet në Kur'an:

Le të mos mendojnë ata të cilët me zili mbajnë dhe nuk japin nga ato gjëra që u ka dhuruar Allahu nga Begatitë e Tij se kjo është më mirë për ta. Përkundrazi, do të jetë akoma më keq për ta; gjërat që ata nga zilia nuk i jepnin do t'u varet si kular në qafë në Ditën e Ringjalljes.

(Sure Al 'Imran:180).

Që njeriu të fitojë pëlqimin e Allahut, duhet që individi t'i përdorë të mirat materiale, që i ka dhuruar Allahu, sa më mirë, pa u frikësuar se këto burime do të mbarojnë. Në Kur'an, Allahu tërheq vëmendjen ndaj këtij rreziku dhe na kujton se Shejtani e kërcënon njeriun me «varfëri» (Sure el-Bekare: 268). Më tepër thuhet se Allahu shpërblen çdogjë që shpenzohet në rrugën e Tij. Ajeti për këtë çështje, është ky që vijon.

Thuaj: “Padyshim se Zoti im shton Riskun për kë Ai do nga robt e Tij dhe pakëson për ta dhe çfarëdo që të shpenzoni ju nga ndonjë gjë, Ai do t'jua zëvendësojë atë. Dhe Ai është më i miri Furnizues”.

(Sure Sebe': 39)

Historia e Karunit në fakt na tregon një veti të përgjithshme të shoqërisë injorante. Një vështrim më nga afër i historisë tregon se Karuni mund të ishte një përfaqësues i kësaj shoqërie e cila përfshinte njerëz të pasur dhe prestigjozë.

Në këto ajete i referohet edhe atyre që e kanë zili Karunin. Këta njerëz përdorin të njëjtin arsyetim të gabuar si të Karunit dhe nuk kuptonin se është Allahu Pronari i vërtetë. Kështu, ata i japin shumë rëndësi Karunit dhe të mirave të tij materiale.

Ata që largohen nga influencat e shoqërisë janë besimtarë të vërtetë:

Meqë kriteri i besimtarëve nuk është paraja por feja dhe meqë dinë se çdogjë i përket Allahut, ata kuptuan se nuk ishte e mënçur të kishin zili Karunin. Më tepër akoma, ata kuptuan se ai ishte në një pozitë të mjerë.

Ndryshe nga njerëzit injorantë, ata nuk thanë: «Allahu i jep begati atij që e do më shumë» pas vdekjes së Karunit por e dinin këtë fakt që në fillim.

Një situatë e ngjashme lidhet me historinë e «pronarëve të vreshtave». Dallimi mes një njeriu të cilit i është dhënë shumë nga begatitë dhe tokat, si në rastin e Karunit, dhe një besimtari, i cili kryen detyrimet e tij ndaj Allahut, tregohet në Kuran në këto ajete:

Dhe sillu atyre shembullin e dy vetave: njerit prej tyre Ne i patëm dhënë dy kopshte me vreshta dhe ia patëm rrethuar që të dy me hurma ndërsa ndërmjet tyre patëm vendosur fusha të gjelbëruara bereqeti. Secili prej atyre dy kopshteve jepte prodhimet e tij dhe nuk e humbën aspak begatinë e frutave të tyre; po kështu Ne bëmë edhe lumë të gurgullojë mes tyre. Dhe kështu ai pati fruta të bollshëm. I tha shokut të tij gjatë një bisede të rastit me të: “Unë kam më shumë se ti pasuri dhe jam më i fortë e i nderuar ndër njerëz.” Dhe shkoi pastaj në kopshtin e tij në gjendje të tillë i padrejtë për veten e vet. Tha: “Nuk më duket se do të shterojë gjithë kjo ndonjëherë. Edhe nuk mendoj se Ora e Fundit do të vijë ndonjëherë dhe vërtetë nëse do të sillesha prapë te Zoti im , sigurisht që do të gjeja më tepër begati se kjo kur të kthehesha tek Ai.” Shoku i tij i tha gjatë bisedës me të: “A shpreh mosbesim në Atë i Cili të krijoj ty nga dheu pastaj nga lëngu i ngjizur pastaj të dha formën e burrit? Sa për mua, unë besoj se Ai është Allahu, Zoti im dhe nuk do të bashkoj kurrë ndokënd ose ndonjë gjë me Zotin tim. Do të ishte më mirë për ty të thoje kur hyre në kopshtin tënd: ‘Kjo është ajo që do Allahu! Nuk ka fuqi veçse në Allahun’. Nëse më sheh mua me më pak pasuri dhe fëmijë, mundet që Zoti im të më jap mua më tepër mirësi se kopshti yt dhe të dërgoj mbi tëndin papritur rrufe nga qielli, pastaj do të bëhet veçse hapësirë dheu e rëre. Ose uji prej andej mund të humb e të fundoset në tokë saqë ti nuk do të mundesh as ta kërkosh.” Kështu frutat e tij u mbështollën dhe ai mbeti duke fërkuar duart me keqardhje për çfarë kishte

shpenzuar në të, ndërkohë që ajo pasuri u shkatërrua e gjitha që nga rrënjët nga të gjitha anët, ai vetëm mundi të thoshte: “Ah! Vetëm sikur të mos i kisha vënë shok Zotit tim!” Dhe ai nuk pati asnjë grup njerëzish që ta ndihmonin atë kundër Allahut dhe as nuk ishte në gjendje të mbronte e të shpëtonte veten e vet. Ditën e Llogarisë fuqia do të jetë vetëm për Allahun, Zotin e Vërtetë. Ai është më i Miri për shpërblim dhe më i Miri për suksesin e fundit.

(Sure el-Kehf: 32-44)

PRIJËSIT E SHOQËRIVE KU ZOTËRIMI I PARAVE ËSHTË KRITERI BAZË

Pothuajse në çdo histori në Kur’an, Allahu përmend një grup njerëzish, të cilëve Muslimanët u njoftojnë mesazhin e Tij. Megjithatë, në vend që t’i ndreqë, komunikimi i fesë së vërtetë këtyre njerëzve, i bën ata më arrogantë dhe shtypës. Kur’ani na jep veçoritë e këtij grupi njerëzish që shfaqen gati në të gjitha historitë e profetëve.

Në Kur’an, ky segment i shoqërisë përkufizohet me fraza si «prijës arrogantë të njerëzve», «ata që këmbëngulin në veprat e këqija» dhe «ata që ishin më kot mendjemëdhenj mbi tokë». Në Kur’an, «prijësit» përshkruhen në Suren Sebe’:

Ne nuk dërguam këshillues në ndonjë vendbanim, veçse gjithnjë ata të cilëve u ishte dhënë pasuria dhe begatia e kësaj bote nga mesi i tyre do të thoshin: “Ne nuk besojmë në Mesazhin me

të cilin ju jeni dërguar.” Dhe ata thonë: “Ne kemi më tepër pasuri e fëmijë dhe nuk do të ndëshkohemi.”

(Sure Sebe’: 34-35)

“Pasuritë dhe fëmijët” e këtyre njerëzve u shtohen arrogancës dhe mohimit të tyre ndaj Allahut.

Sa për Aadin, ata qenë mospërfillës në tokë, pa të drejtë dhe për më tepër thanë: “Kush është më i fortë se ne në fuqi e pushtet?” Po a nuk e shihnin ata se Allahu i Cili i krijoi ata, ishte më i fortë se ata në fuqi e pushtet? Dhe qenë që gjithnjë i mohonin Ajetet Tona!

(Sure Fusilet:15)

Ky segment shoqërie krijon një armiqësi të qëndrueshme kundër atyre që besojnë te Allahu. Njëlloj, besimtarët shpesh hasin sjellje të ashpra nga këta njerëz të cilët ushqejnë zemërim dhe urrejtje ndaj tyre. Si pasojë e kësaj urrejtjeje, disa prej tyre u përpoqën t’i zhduknin ata:

Prijësit kryelartë nga populli i tij i thanë: “Me të vërtetë që do t’ju nxjerrim jashtë qytetit tonë, o Shuajb dhe ata që kanë besuar me ty, ose përndryshe ju të gjithë do të ktheheni në fenë tonë.” Ai tha: “Edhe sikur ne ta urrejmë atë!”

(Sure al-A’raf: 88).

Shembuj njerëzish të tillë, që hasen shpesh në Kur’an, ekzistojnë edhe në shoqëritë e sotme. Kur vëzhgojmë vetitë kryesore «të atyre që jetojnë mirë» siç përmendet në Kur’an, çështja bëhet e evidente, pasi ka disa linja paralele mes tyre dhe një shtrese të caktuar të shoqërisë që kanë përshtatur treguesit e injorancës. Kjo shtresë quhet «shtresa e lartë» e gjendur pothuajse në gjithë

botën. Jeta e anëtarëve të këtij komuniteti, që ka një standart shumë më të lartë se mesatarja, është thjesht e degjeneruar. (Sigurisht, ka nga ata me sjellje të mirë dhe me sjellje të keqe). Festat që filojnë tek klubet e mbarojnë në shtëpi, spektaklet e bazuara në një argëtim të ekzagjeruar, të rinj të shkatërruar nga abuzimi i drogave, disfata morale që paaftësojnë individët nga të qenit të ndershëm dhe të besueshëm, alkooli i tepruar, shpenzime ekstravagante, etj., paraqiten si «naturale» në këtë ambient social të pakontrolluar.

Disa nga anëtarët e kësaj shoqërie shfaqin të gjitha karakteristikat e shoqërive perverse të përmendura në Kur'an: homoseksualizmi i njerëzve të Lutit, ngacmimi i besimtarëve, si në rastin e Nuhut (Sure Hud:38), shfrytëzimi i të mirave materiale të njerëzve me kamatë nga bijtë e Izraelit (Sure an-Nisa':161)

Ata paraqesin një jetë pa moral, ndërsa njerëzit e thjeshtë mezi mbijetojnë edhe pse punojnë shumë dhe ndershmërisht. Këta njerëz, që harxhojnë shuma të mëdha parash, më tepër se një pagë mesatare, në një natë të vetme, i shkaktojnë dëm të madh shpirtëror shoqërisë në përgjithësi. Në këtë pikë, rikujtojmë që Kur'ani na informon për fundin e këtyre «udhëheqsve që jetojnë pa frikë», përderisa ata nuk pendohen dhe nuk heqin dorë përfundimisht nga kjo jetë.:

Derisa, kur Ne i mbulojmë ata që jetojnë në rehati e luks, me ndëshkim, ç'të shohësh! Lutën të nënshtruar me rënkim. Mos u lutni me zë të lartë këtë ditë! Sigurisht që nuk do të ndihmoheni prej Nesh.

(Sure al-Mu'minun:64-65)

MORALET NË SHOQËRINË E TË PADITURVE

Morali i besimtarëve të përshkruar në Kur'an bazohet në frikë-respektin ndaj Allahut. Meqë të tjerët nuk gjykojnë duke u bazuar mbi këtë devocion, edhe vlerat e tyre morale devijojnë.

Meqë shoqëria e «të paditurve» nuk sheh fuqinë e pafund të Allahut, botëkuptimi i tyre moral varet nga opinioni i të tjerëve. Ky botëkuptim lejon kryerjen e veprimeve të papranueshme në një ambient ku nuk i sheh apo dëgjon njeri. Ndryshe, kjo shpjegohet kështu. Shumë njerëz në këtë shoqëri, i konsiderojnë marrëdhëniet seksuale jashtë martese si imorale. Disa nga individët që e bëjnë këtë vështirë se e pranojnë. Megjithatë, nuk e evitojnë aspak përderisa nuk i sheh njeri tjetër.

Mund të shohim forma të ngjashme me këtë në jetesat e njerëzve të paditur.

DËSHIRA PËR TË JETUAR PËRGJITHMONË.

Thuaju: “Sigurisht që vdekja prej së cilës ju ikni, padyshim që do t’ju kapë, pastaj do të ktheheni prapë tek i Gjithëdituri i së fshehtës dhe i së shfaqurës dhe Ai do t’ju tregojë juve çfarë keni punuar.”

(Sure el-Xhumuah:8).

Duke mos njohur ekzistencën e Allahut dhe të botës tjetër, anëtarët e shoqërisë “mohuese” sillen «sikur nuk do vdesin kurrë». Në këtë shoqëri, vdekja është një nga fjalët që nuk përmendet kurrë. Ata grumbullojnë të ardhura sikur jeta e kësaj bote të ishte e pambarueshme. Planet e tyre i përkasin vetëm kësaj bote.

Ky është një nga treguesit kryesorë të konceptimit të shtrembër mbi të cilin mosbesimtarët bazojnë jetët e tyre. Meqë “gjithsecili do ta shijojë vdekjen” (Sure Al’Imran: 185), jeta në «harresë» të vdekjes padyshim është drejt prishjes. Megjithatë, njeriu duhet të përdorë intelektin e tij:

Meqë ka dëshirë të jetojë përgjithmonë, duhet edhe të mendojë pse jeta e tij kufizohet brenda 60-70 vjetëve.

Duhet ta pranojë llogjikën e gabuar, d.m.th. sikur të mos mendojë për vdekjen është një mënyrë për ta mbajtur atë larg tij. Kjo është si sjellja e strucit që e fut kokën nën rërë.

Duhet të kuptojë faktin që Allahu, I Cili e formoi trupin e tij në formën më të bukur, ka fuqinë ta rikrijojë atë dhe t’i japë një jetë të re.

Së fundi, të ngulitë mirë në mend që Allahu, I Cili premtoi dhe deklaroi në qindra ajete se Ai do ta rikrijonte atë pas vdekjes, padyshim që do ta mbajë premtimin e Tij.

Të gjitha këto më lart do ta çojnë njeriun të kuptojë se vdekja nuk është një formë zhdukjeje, por një shndërrim në botën tjetër.

Në këtë rast, ai mund të kuptojë gjithashtu se frika për vdekjen është e pakuptimtë. Në fakt kjo nuk do ta ndihmojë; vdekja është e paevitueshme. Të gjithë do vdesim në një moment të paracaktuar. Ata që e kanë frikë vdekjen përmenden dhe në Kur'an si më poshtë:

...Ata fshehin në veten e tyre çfarë ata nuk guxojnë të ta shprehin ty, duke thënë: “ Në qoftë se nuk do të kishim lidhje me këtë çështje, atëherë askush prej nesh nuk do të ishte vrarë këtu.” Thuaju: “Edhe sikur ju të kishit ndenjur në shtëpitë tuaja, ata për të cilët ishte përcaktuar vdekja, padyshim që do të ishin drejtuar vetë për te vendi i caktuar për vdekjen e tyre.”

(Sure Al'Imran:154)

Vdekja, që është një derë për botën tjetër, i sjell lumturi dhe shpëtim vetëm atyre që kaluan jetën në përputhje me kënaqësinë e Allahut. Për ata që u larguan nga Allahu, nga ana tjetër, vdekja nënkupton shkatërrim total dhe fillimin e një katastrofe. Kur'ani na informon se kur vjen vdekja, nuk do të vlejë pendimi i atyre që e kanë harruar Allahun:

Dhe pa asnjë përfitim është pendimi i atyre të cilët vazhdojnë të bëjnë vepra të këqija deri sa t'u vijë përballë vdekja dhe pastaj thotë: “Tani pendohem”; as edhe i atyre që vdesin duke qenë jobesimtar. Për ta Ne kemi përgatitur dënim të dhimbshëm.

(Sure an-Nisa': 18)

Kur vdekja vjen mbi një keqbërës thotë: “Zoti im! Më kthe prapë, që të mund të bëj mirësi në çfarë kam mbetur mbrapa!” Jo! Është veçse një fjalë që ai e flet, ndërsa pas është perde deri Ditën kur do të sillen përsëri në jetë.

(Sure el-Mu'minun: 99-100)

Çdokush që nuk i ka kushtuar jetën e tij Allahut do të jetojë duke vuajtur këtë pendim përderisa Allahu të dojë.

Konsiderojeni jetën shumë të shkurtër, se ka me të vërtetë një jetë reale, të përjetshme, pas jetës së kësaj bote dhe se mund ta fitoni atë vetëm duke fituar pëlqimin e Allahut në këtë botë.

Duhet të kujdesemi për jetën e vërtetë, atë pas vdekjes, më shumë se për jetën e kësaj bote e cila është e shkurtër dhe e pakrahasueshme me mirësitë e pafundme të premtuara. Për këtë arsye, besimtarët janë nga ata që “u zgjodhën duke u dhuruar mirësinë e mesazhit të përkujtimit të Shtëpisë” (Sure Sad: 46)

Eshtë e pakuptimtë të mashtrohesh nga luksi i kësaj bote dhe të lidhesh ngushtë me të. As pasuria, bukuria, pushteti, familja apo fama nuk do ta shoqërojnë njeriun në varr.

Çfarë do të merret me vete në botën tjetër janë veprat e mira dhe të devota të kryera me qëllim për të fituar aprovimin e Allahut. Atje, të mirat e përkohshme të kësaj bote (shëndeti, bukuria, pasuria e me rradhë), do t’ju jepen njeriut, në formën e tyre më të mirë, për përjetësi.

Ai që nuk e kupton këtë fakt, dhe nga kopracia nuk shpenzon në rrugë të Allahut, padyshim shkatërron jetën e tij të përjetshme dhe në botën tjetër dhe dëmton vetëm veten e tij:

Vini re, pra! Ju jeni ata që ju është bërë thirrje të shpenzoni për çështjen e Allahut, megjithatë mes jush ka prej atyre që janë dorështrënguar. Dhe kushdo që është dorështrënguar është i tillë vetëm për llogari të tij. Por Allahu është më i Pasuri dhe ju jeni të varfër. Edhe nëse ju braktisni, Ai do t’ju zëvendësojë ju me një popull tjetër, pastaj ata nuk dotë jenë në shembullin tuaj.

(Sure Muhammed: 38)

Ata që nuk e kuptojnë këtë dhe lidhen ngushtë me këtë botë përpiqen të fitojnë të ashtuquajturën «pavdekshmëri» duke dëshiruar «të lënë diçka në këtë botë me të cilën njerëzit të mund ta kujtojnë atë». Kjo dëshirë shfaqet në forma të ndryshme:

Disa përpiqen të lënë pas «vepra arti» që «emri i tyre të jetojë mbi to»: Për këtë sjellje Kur’ani thotë:

“A ndërtoni pallate të larta në çdo kodrinë, ndërsa nuk banoni në to, dhe mbani për vete pallate sikur do të jetoni në to përgjithmonë?”

(Sure esh-Shu’ara: 128-129)

Ky arsyetim shprehet më mirë në dëshirën për të «pasur fëmijë». Ata që nuk shpresojnë në botën tjetër shpresojnë të kenë fëmijë që të mbartin emrin e familjes në të ardhmen. Kjo është arsyeja kryesore pse familjet preferojnë djem.

Thuhet në një ajet tjetër që dëshira për të «pasur fëmijë» është pjesë e madhështisë së përkohshme të kësaj bote:

Dijeni se jeta e kësaj bote është vetëm lojë dhe qejf dhe salltanet dhe mburrje e ndërsjellë mes jush dhe rivalitet për pasuri e fëmijë tamam si bimësia pas shiut ku rritja e saj e kënaq bujkun; më pas ajo thahet dhe e shihni të zverdhet, pastaj ajo bëhet kashtë. Por në Jetën e Pastajme është dënimi i ashpër dhe Falje nga Allahu dhe Kënaqësia e Tij. Jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.

(Sure el-Hadid: 20).

Sigurisht që është më e pranueshme të dëshirosh fëmijë me vlera të mira morale. Por në sistemin e shtrebbër të shoqërisë mohuese, arsyeja e kësaj dëshire nuk është të kënaqësh Allahun por të kënaqin arrogancën e tyre dhe të lënë një shenjë pas tyre në këtë botë.

Megjithatë, kur i referohemi Kur'anit, dëshmojmë qëndrimin e besimtarëve të vërtetë; ata i kërkojnë Allahut fëmijë vetëm nëse kjo është për kënaqësinë e Tij. Shumë nga profetët jetuan pa pasur fëmijë meqë nuk e patën këtë mundësi gjatë kohës së tyre dhe kërkuan fëmijë nga Allahu vetëm kur u plakën dhe kishin nevojë për dikë që të vazhdonte komunikimin e mesazhit të Allahut dhe përhapjen e fesë së Tij.

Prandaj, «pasja e fëmijëve» është e nevojshme vetëm nëse kjo përputhet me dëshirën e Allahut. Është gabim i madh ta bësh këtë vetëm për dëshirën instinktive të vazhimit të emrit të familjes apo për sy të njerëzve, ashtu siç bëjnë mosbesimtarët.

KONCEPTIMI I FESË NË SHOQËRINË E PADITURISË.

Njerëz të tillë, të përshkruar më lart, të cilët nuk i japin Allahut vlerësimet e duhura pra janë «të paditur», e kanë interpretuar besimin, fenë sipas llogjikës dhe bestytnive të tyre të shtrebbëra. Konceptimi rezultat i fesë tregon devjime të dukshme nga feja origjinale e parashtruar nga Kur'ani. Kur'ani e përkufizon fenë e sjellë me Profetin Muhammed (s.a.u.s.) si një fe që : “i çliron njerëzit nga barrët e rënda dhe nga prangat që qenë mbi ta” (Sure al-A'raf: 157) dhe si një fe që «nuk përmban vështiësi në të»:

...Ai ju ka zgjedhur ju dhe nuk ka venë ndonjë mundim në fë; është feja e babait tuaj Ibrahimit. Është Ai që ju ka emërtuar Muslimanë...

(Sure el-Haxh: 78)

Në Kur'an, Allahu thërret njerëzit të reflektojnë dhe, pasi të shohin bestytnitë e gabuara dhe metodat që ndjekin, të kthehen në atë jetë që mendohet nga Allahu si më e përshtatshme.

Të paditurit, që bëjnë sikur nuk kuptojnë mesazhin e qartë dhe të kuptueshëm të Kur'anit, kanë fabrikuar, në emër të Islamit, një fë jotolerante dhe të cekët. Disa nga karakteristikat e kësaj feje të shtrembër janë si më poshtë:

Feja e prezantuar në Kur'an i thërret njerëzit të shërbejnë vetëm Allahun dhe kështu i çliron ata nga pesha e të gjitha qenieve të tjera. Meqë nuk detyrohet të arrijë kënaqësinë e njerëzve të tjerë, individi është përgjegjës vetëm të fitojë pëlqimin e Allahut. Njerëzit e shoqërisë së paditur kanë zhvilluar një konceptim të fesë që nuk kërkon të arrijë këtë por thjesht është një institucion shoqëror. Duke veshur këtë perceptim, kjo fë fallso bie në një formë që së pari shqetësohet me faktin «çfarë do mendonin njerëzit» - mendim shumë i largët nga feja e vërtetë.

Me këto keqkuptime rreth fesë, shoqëria e paditur ka ekuivalentuar, në masë të gjërë, fenë me traditën. Ritet dhe bestytnitë lokale apo faktorët kulturorë janë shkrirë me fenë e cila, «duke qenë kaq e devotshme», ka prishur «traditat e stërgjyshërve të tyre». Feja e sjellë nga Kur'ani dhe e mishëruar në jetën shembullore të Profetit (s.a.u.s.) nuk ka aspak ngjasim me këto. Në Kur'an, Allahu urdhëron njeriun të ruajë kufijtë e Tij dhe të konsiderojë sunnetet e Profetit (s.a.u.s.) si një matje apo vlerësim. Gjatë historisë, profetët kanë luftuar me ata që kërkonin të mohonin të

vërtetën vetëm për ruajtjen e bestytive të trashëguara nga stërgjiyshërit e tyre. Morali që ata shfaqën tregohet në ajetin e mëposhtëm:

Kur u thuhet atyre: “Ndiqni atë që ka zbritur Allahu”, ata thonë: “Jo! Më mirë ne do të ndjekim çfarë gjetëm nga baballarët tanë”. Edhe pse baballarët e tyre nuk kuptonin gjë dhe nuk ishin të drejtuar!

(Sure el-Bekare: 170)

E njëjta temë përsëritet në suret el-Ma’ideh: 104, An’am:91, al-A’raf: 28 dhe në shumë ajete të tjera

Ata që e konsiderojnë fenë si një institucion shoqëror dhe e identifikojnë atë me traditat në të vërtetë e kanë larguar fenë nga llogjika bazë. Megjithatë, ashtu siç na informon dhe Kur’ani, të jesh Musliman do të thotë të jesh i mençur, i urtë. Besimtarëve u kërkohet gjithmonë të mendojnë, të vëzhgojnë dhe kështu pra të shohin ajetet e Kur’anit. Feja dhe urtësia janë të ndërlidhura; duke praktikuar urtësinë fiton besim dhe besimi rritet sa më shumë të përdorësh urtësinë. Kurse, të paditurit e mendojnë fenë të përbërë vetëm nga besimi, por urtësia është çelësi i aftësisë së të kuptuarit të ekzistencës së Allahut dhe veçorive të Tij. Për pasojë, besimi në Allahun në këtë shoqëri ka natyrë shumë të dobët. Për të mos tronditur këtë fëmijë të dobët, anti-Kur’anore, ata zhvillojnë një qëndrim të paarsyeshëm që nënkupton se «të mendosh thellë mbi çështjet fetare mund të jetë e dëmshme për besimin»

Kjo llogjikë, që lind nga mosdija, nuk pengon futjen e principeve të reja në fëmijë si dhe lejon bërjen të paligjshme asaj që është e ligjshme.

Kur'ani shpesh tërheq vëmendjen ndaj kësaj llogjike «ndaluese» që shqetëson shumë njerëz:

Thuaj: “Kush e ka ndaluar veshjen bukur me rrobat e dhuruara prej Allahut, të cilat Ai i ka krijuar për robt e Tij si dhe ushqimet e pastra si mirësi për ju?”

Thuaj: “Gjërat që ka ndaluar Zoti im janë gjynahet e mëdha që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet e çdolloji, shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim, gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë e asnjë provë si dhe përfojja për Allahun për gjëra për të cilat ju nuk keni asnjë dijeni.”

(Sure al-A'raf: 32-33)

Dhe pse të mos hani nga ai (mish) mbi të cilin është përmendur Emri i Allahut, në një kohë kur Ai jua ka shpjeguar juve me imtësi se çfarë ju ndalohet përveçse rastet e shtrëngesës nga mospasja? Dhe vërtetë, shumë e shtyjnë në gabim popullin me dëshirat e tyre me dije e pa dije. Padyshim që Zoti yt i di më mirë ata që i kalojnë kufijtë.

(Sure En'am:119)

O ju që keni besuar! Mos i bëni të paligjshme gjërat e mira të cilat Allahu i ka bërë të ligjshme për ju dhe mos i kaloni kufijtë. Është e vërtetë se Allahu nuk i do thyerësit e ligjeve.

(Sure al-Ma'idh:87)

Si rezultat i këtij degjenerimi të shkaktuar nga shoqëria e mosdijes, Islami po paraqitet si «një fëmijë e posaçme për beduinët». Por faktet janë ndryshe. Profetët kanë qenë gjithmonë më të civilizuarit e kohës së tyre. Ata ishin njerëz të kulturuar dhe të ndriçuar me vlera estetike të rafinuara. Me

pallatin e tij, i cili njihet të jetë një kryevepër arkitekturale, Profeti Sulejman (a.s.) është një nga shembujt më të shquar të përmendur në Kur'an.

Të jesh Musliman nuk do të thotë të jesh i ngjitur pas një tradite kulturore apo vlerave nostalgjike. Padyshim që nuk do të thotë të jesh patjetër «lindor» apo as të jesh ndjekës i një kulture të vetme. Të jesh Musliman do të thotë të jesh shërbyes i Allahut dhe të jesh mirënjohës për të mirat e Tij. Do të thotë të përpiqesh ta njohësh Allahun, t'i afrohesh Atij dhe të jesh një qenie njerëzore me karakter fisnik.

Një Musliman i vërtetë është ai që kërkon pëlqimin e Krijuesit të tij, Allahut, të Gjithfuqishmit, dhe që rri larg çdo parashikimi material apo shpirtëror përveç atyre që i bëjnë të fitojë kënaqësinë e Tij. Ky është pra, përkufizimi i Muslimanit.

VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË PRANOJNË TË ADHURUAR TË TJERË VEC ALLAHUT: FERRI

A është atëherë ai që ndjek dhe kërkon Kënaqësinë më të mirë të Allahut, njësoj si ai që tërheq mbi vete Zemërimin e Allahut? Vendbanimi i tij është Xhehenemi dhe vërtet, sa i keq është një fund i tillë!

(Sure Al'Imran: 162).

Është një vend poshtërimi dhe ndëshkimi të përjetshëm.

(Sure et-Teube: 63,68; Sure el-Ma'ideh: 80; Sure En'am: 128; Sure Hud: 107; Sure en-Nehl: 29; Sure el-Enbija': 99; Sure an-Nisa': 14,151)

Zjarri i tij është i tmerrshëm dhe përcëllues.

(Sure el-Mearixh: 15-16; Sure Al'Imran: 181; Sure el-Ahsab: 64; Sure el-Haxh: 72; Sure en-Nur: 57; Sure el-Furkan: 11)

Ai shungullon dhe zien.

(Sure el-Furkan: 12; Sure el-Mulk: 7-8)

Është vendi më shkatërrimtar që Allahu ka krijuar.

(Sure Al'Imran: 162; Sure an'Nisa': 115)

Ndëshkimi nuk pushon kurrë dhe as lehtësohet ndonjëherë.

(Sure Gafir: 46-47; Sure el-Ma'ideh: 37; Sure Junus: 52; Sure el-Bejjineh: 6; Sure el-Haxh: 22; Sure Al'Imran: 88; Sure Fatir: 36)

Nuk ka mundësi të shpëtosh me anë të vdekjes.

(Sure Ibrahim: 17)

Askush nuk mund të të ndihmoj.

(Sure Al'Imran: 91)

Nuk ka rrugë shpëtimi.

(Sure el-Ma'ideh: 37; Sure el-Kehf: 53; Sure el-Beled: 19-20)

Ruajtësit e Ferrit janë engjëjt.

(Sure el-Muddethir: 31)

Lënda djegëse e zjarrit janë njerëzit dhe gurët.

(Sure el-Bekare: 24; Sure et-Tarim: 6; Sure Al'Imran: 10; Sure el-Enbija: 98; Sure Hud: 119; Sure es-Sexhde: 13)

Do të ketë vuajtje për ata që ndodhen në të.

(Sure el-Enbija': 100)

Keqbërësit lidhen bashkë me pranga.

(Sure Ibrahim: 49)

Do t'u jepen për të pirë ujë të valuar dhe qelb përvëlues.

(Sure en-Nebe': 24-25; Sure el-Gashije: 5; Sure el-Vakia: 54-55; Sure Junus: 4; Sure Sad: 57; Sure Ibrahim: 16-17)

Ushqimet e tij janë pema e skëterrës (zekumi) dhe shkurrja e hidhur me gjemba.

(Sure ed-Dukhan: 43-46; Sure es-Saffat: 62-66; Sure el-Vakia: 52-53; Sure el-Muzemmil: 13; Sure el-Gashija: 6-7)

Atje njerëzit e zjarrit veshin bluza katrani.

(Sure Ibrahim: 50)

VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KËRKOJNË VETËM PËLQIMIN E ALLAHUT: PARAJSA

Ata do të kenë atje çfarë të duan dhe Ne kemi më tepër.

(Sure Kef: 35; Sure ez-Zuhruf: 71; Sure el-Enbija': 102)

Atje është një mbretëri e madhe.

(Sure el-Insan: 20)

Kudo ka mirësi e bekime.

(Sure es-Saffat: 43; Sure el-Insan: 20)

Pasi vdiqën njëherë ata nuk do ta provojnë më vdekjen.

(Sure ed-Dukhan: 56)

Ata, të drejtët, do të banojnë atje përgjithmonë.

(Sure el-Bekare: 25)

Nuk ka as lodhje a mundim.

(Sure Fatir: 35)

Atje ka lumturi të pakufizuar.

(Sure Ja Sin: 55)

Ka qetësim të plotë aty.

(Sure el-Vakia: 89)

Ai është një vend shumë i gjerë.

(Sure el-Hadid: 21)

Jeta atje është në kënaqësi.

(Sure el-Hakkah: 21)

Nuk ka ankth e frikë.

(Sure el-Bekare: 62; Sure Al'Imran: 170; Sure Fatir: 34; Sure el-A'raf: 35)

Njerëzit e kopshteve nderohen pamasë.

(Sure es-Saffat: 42)

Atje ka gra të dlira me sy të zinj të mrekullueshëm, nga një krijim i veçantë, që i ndalojnë shikimet veç për bashkëshortët e tyre.

(Sure el-Bekare: 25; Sure es-Saffat: 48-49; Sure ed-Dukhan: 54; Sure el-Vakia: 22-23; 35-37, Sure err-Rrahman: 56, 58, 70, 72; Sure en-Nebe': 33; Sure el-Vakia: 35-37)

Atje ka ndërtesa të mira me dhoma të larta.

(Sure el-Furkan: 10, 75; Sure el-Ankebut: 58; Sure es-Saff: 12)

Nuk është ftohtë apo nxehtë i tillë që të bezdisë ndokënd. Por është hije dhe freski e përhershme.

(Sure el-Insan: 13; Sure er-Rad: 35; Sure el-Murselat: 41; Sure en-Nisa':57)

Kopshtet ujiten nga lumenjt. (Sure el-Bekare: 25)

Atje ka lumenj uji dhe lumenj qumështi.

(Sure Muhammed: 15)

Ka ushqim të bollshëm.

(Sure Sad: 54; Sure Gafir: 40)

Mirësitë janë të pafundme.

(Sure el-Insan: 13; Sure el-Vakia: 33)

Atje ka fruta të ëmbla që merren lehtë.

(Sure el-Vakia: 28, 29, 32; Sure en-Nebe': 32; Sure el-Hakkah: 23; Sure err-Rrahman: 68; Sure el-Insan: 14)

Atje ka bukuri dhe mirësi të ndryshme.

(Sure err-Rrahman: 48)

Atje ka stola në rradhë të zburuara me qëndisma të rralla.

(Sure err-Rrahman: 54)

Ka të rinj të dliër që i shërbejnë njerëzve të kopshteve.

(Sure et-Tur: 24)

Atje ka djem të rinisë së përhershme si perla të shpërndara.

(Sure el-Insan: 19)

Ka një burim atje të bardhë si bora që i nuk i dëmton ata që e pijnë.

(Sure el-Mutaffifin: 25, 26; Sure el-Insan: 5; Sure es-Saffat: 46-47; Sure el-Vakia: 19; Sure et-Tur:23)

Rrobat janë prej mëndafshi të lehtë dhe qëndisma të bukura, të zbukuruara me ar, argjend dhe perla.

(Sure el-Insan: 21; Sure el-Haxh: 23)

Ushqimet dhe pijet shërbehen me pjata dhe kupa ari dhe argjendi.

(Sure: ez-Zukhruf: 71; Sure el-Insan: 15-16)

KEQKUPTIMI I EVOLUCIONIT

Çdo detaj në këtë univers na orienton drejt një krijimi superior. Nga ana tjetër, materializmi, i cili përpiqet të mohojë faktin e krijimit të universit, nuk është gjë tjetër veç një gabim antishkencor.

Nëse materializmi pranohet, të gjitha teoritë e tjera të bazuara në këtë filozofi bëhen të pabaza. Më kryesorja nga këto teori është Darwinizmi, ose, teoria e evolucionit. Kjo teori, që pohon se jeta filloi nga lënda jo e gjallë nëpërmjet rastësisë, është rrëzuar me pranimin se universi është krijuar nga Allahu. Astrofizikanti amerikan Hugh Ross e shpjegon këtë si më poshtë:

Ateizmi, Darwinizmi dhe teoritë e tjera, që burojnë nga filozofitë e shek. XVIII - XX, janë ndërtuar mbi supozimin, supozim ky i gabuar, se universi është i pafund. Çudia na ka sjellë ballë për ballë me shkakun e gjithë kësaj, universin dhe çfarë përmban ai, duke përfshir dhe vetë jetën.
1)

Është Allahu Ai që krijoi universin dhe e modeloi atë deri në detajin më të vogël. Prandaj, është e pamundur që teoria e evolucionit, që thotë se gjallesat nuk u krijuan nga Allahu por janë prodhim i rastësive, të jetë e vërtetë.

Çuditërisht, kur ne shikojmë teorinë e evolucionit, shohim se kjo teori mbështetet mbi zbulime shkencore. Modelimi i jetës është shumë kompleks dhe mahnitës. Në botën jo të gjallë, mund të vërejmë sa të ndjeshme janë ekuilibrat mbi të cilat qëndrojnë atomet, dhe më tepër akoma, në botën e gjallë, mund të vëzhgojmë se në ç'mënyrë komplekse këto atome vendosen bashkë dhe se si formojnë mekanizma dhe struktura të jashtëzakonshme si proteinat, enximat dhe qelizat. Ky modelim i jetës bëri të pavlerë Darwinizmin në fund të shek. të 20-të. Ne e kemi trajtuar në detaje

këtë çështje në disa nga studimet tona dhe do vazhdojmë ta bëjmë. Por, duke konsideruar rëndësinë e saj, mendojmë se do ishte ndihmëse të bënim dhe këtu një përmbledhje të saj.

RRËZIMI SHKENCOR I DARVINIZMIT

Edhe pse është një doktrinë e vjetër që nga Greqia e lashtë, teoria e evolucionit përparoi gjerësisht në shek. e 19-të. Zhvillimi më i rëndësishëm, që e bëri këtë teori objektin kryesor të botës së shkencës, ishte libri i Çarls Darvin me titull «Origjina e specieve» i botuar në vitin 1859. Në këtë libër, Darvini mohoi se specie të ndryshme të gjalla ishin krijuar veç e veç mbi tokë nga Allahu. Sipas Darvinit, të gjitha qeniet e gjalla kishin një paraardhës të përbashkët dhe ato u ndanë me kalimin e kohës nëpërmjet ndryshimeve të vogla. Teoria e Darvinit nuk bazohet mbi zbulime konkrete shkencore; siç e pranonte dhe vetë ai, kjo ishte një supozim. Për më tepër, Darvini rrëfeu, në kapitullin e gjatë të librit të tij të quajtur «Vështirësitë e teorisë», se teoria hidhej poshtë para shumë pyetjeve kritike.

Darvini investoi të gjitha shpresat e tij në zbulime të reja shkencore, me të cilat të mund të zgjidhte «Vështirësitë e teorisë». Por, në kundërshtim me këtë, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive.

Humbja e Darwinizmit përkundrajt shkencës mund të përmbledhet në këto pika kyçe:

Teoria nuk mund të shpjegojë me asnjë mjet si lindi jeta në tokë.

Nuk ka asnjë zbulim shkencor që tregon se «mekanizmat evolues» të propozuar nga teoria të kenë ndonjë fuqi për të evoluuar ndopak.

Fosilet tregojnë krejtësisht të kundërtën e sugjerimeve të teorisë së evolucionit

HAPI I PARË I PAKAPËRCYESHËM: ORIGJINA E JETËS

Teoria e evolucionit pranon se të gjitha gjallesat evoluuan nga një qelizë e vetme e gjallë që u shfaq papritur në tokën primitive 3.8 bilionë vjet më parë. Si mund të gjenerojë një qelizë e vetme miliona gjallesa komplekse dhe, nëse një evoluim i tillë ndodhi me të vërtetë, pse nuk ekzistojnë gjurmë të tij në mbetjet fosile, janë disa nga pyetjet që teoria nuk mund t'i përgjigjet. Megjithatë, duhet të hetojmë mbi procesin e parë dhe më të rëndësishëm evolues. Si lindi «qeliza e parë».

Meqë teoria e evolucionit mohon krijimin dhe nuk pranon asnjë lloj ndërhyrjeje mbinatyrore, ajo pranon se «qeliza e parë» lindi rastësisht brenda ligjeve të natyrës, pa ndonjë modelim, plan apo rregullim. Sipas teorisë, lënda e pajetë mund të ketë prodhuar një qelizë të gjallë si rezultat i rastësive. Kjo është një thënie e papërputhshme edhe me rregullat më të pacënueshme të biologjisë.

«JETA VJEN NGA JETA»

Në librin e tij, Darvini asnjëherë nuk iu drejtua originës së jetës. Konceptimi primitiv i shkencës në kohën e tij mbështetej mbi supozimin se gjallesat kishin një strukturë shumë të thjeshtë. Që nga mesjeta, teoria, se materialet jo-të-gjallë bashkoheshin për të formuar organizma të gjallë, u pranua gjerësisht. Ishte normale të besohej se insektet lindnin nga ushqimi i mbetur dhe minjtë nga drithi. U bënë dhe eksperimente interesante për të vërtetuar këtë teori. Vihej pak grurë mbi një copë të vjetër dhe besohej se minjtë do të lindnin nga ai pas pak.

Po njësoj krimbat nga mishi i prishur, supozohej se shfaqeshin spontanisht. Megjithatë, vetëm pak kohë më pas u kuptua se krimbat mbarteshin nga mizat në formë larvash të padukshme për syrin njerëzor.

Edhe në kohën kur Darvini shkroi «Origjina e specieve», mendimi se bakteret do mund të zhvilloheshin nga lëndë jo të gjalla pranohej gjerësisht në botën e shkencës.

Pesë vjet pas botimit të librit të Darvinit, Luis Pastër shpalli rezultatet e tij, pas shumë eksperimenteve dhe studimeve të gjata, të cilat hidhnin poshtë lindjen spontane, një shtyllë kjo e teorisë së Darvinit. Në leksionin e tij triumfoz në Sorbonë në 1864, Pastër tha: «Doktrina e zhvillimit spontan nuk do ta marrë më veten nga goditja për vdekje e këtij eksperimenti të thjeshtë»²⁾.

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i rezistuan zbulimeve të Pastërit për një kohë të gjatë. Megjithatë, ndërsa zhvillimi i shkencës sqaroi strukturën komplekse të qelizës së një gjallese, idea, se jeta mund të lindte rastësisht, ndeshi një pengesë akoma më të madhe

PËR PJEKJE PA REZULTAT NË SHEKULLIN E NJËZETË

Evolucionisti i parë që u interesua për origjinën e jetës në shekullit të 20-të ishte biologu i shquar rus Aleksandër Oparin. Nëpërmjet teorive të ndryshme që zhvilloi rreth viteve 1930, ai u përpoq të provonte se qeliza e një gjallese mund të krijohej rastësisht. Këto studime, sidoqoftë, ishin të destinuara të dështonin, dhe Oparin u detyrua të rrëfehej kështu: «Fatkeqësisht, problemi i origjinës së qelizës është padyshim pika më e errët e të gjithë studimit të evoluimit të organizmave»³⁾.

Ndjekësit evolucionistë të Oparin u përpoqën me eksperimente të zgjidhnin problemin e origjinës së jetës. Eksperimenti më i njohur prej tyre u krye prej një kimisti amerikan Stenli Miller në vitin 1953. Duke kombinuar gazet, të cilat ai pranoi se patën ekzistuar në atmosferën fillestare të tokës, dhe duke i dhënë energji përzierjes, Miller arriti të sintetizonte disa molekula organike (aminoacidet) të pranishme në strukturën e proteinës.

Vetëm pak vjet kishin kaluar përpara se të zbulohej se ky eksperiment, i cili atëherë paraqitej si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm pasi atmosfera e menduar ishte shumë ndryshe nga kushtet reale të tokës 4)

Pas një heshtjeje të gjatë, Miller pranoi se atmosfera që ai përdori ishte joreale.5)

Të gjitha përpjekjet e evolucionistëve, të parashtruara në shek. e 20-të për të shpjeguar origjinën e jetës, dështuan. Gjeokimisti Xhefri Bada nga Instituti i San Diegos e pranon këtë fakt në një artikull të botuar në revistën «Earth» (Toka) në 1998:

Ndërsa lëmë pas shekullin e 20-të, përballemi sërish me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim edhe kur e filluam këtë shekull: Si lindi jeta në tokë? 6)

STRUKTURA KOMPLEKSE E JETËS

Arsyeja kryesore pse teoria e evolucionit ndodhej në një qorrsokak të tillë përse i përket origjinës së jetës është se edhe organizmat më të thjeshta kanë një strukturë jashtëzakonisht komplekse. Qeliza e një gjallese është më komplekse se të gjitha prodhimet teknologjike të ndërtuara nga njeriu. Sot, edhe në laboratorët më të përparuar të botës, nuk mund të prodhohet një qelizë duke mbledhur bashkë materiale inorganike.

Kushtet e nevojshme për formimin e një qelize janë të shumta. Probabiliteti që proteinat, tullat përbërse të qelizës, të sintetizohen rastësisht, është 1 në 10^{950} për një proteinë mesatare të përbërë prej 500 aminoacidesh. Në matematikë, një probabilitet më i vogël se 10^{50} konsiderohet praktikisht i pamundur.

Molekula e ADN-së, e cila ndodhet në bërthamën e qelizës dhe ruan informacionin gjenetik, është një strukturë e pabesueshme. Është llogaritur se nëse informacioni i koduar në ADN do shkruhej i gjithi, do formohej një librari gjigande prej 900 volumesh enciklopedike me 500 faqe secila.

Në këtë pikë del papritur një dilemë interesante: ADN-ja mund të formohet me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimat). Megjithatë, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me informacionin e koduar tek ADN-ja. Meqë të dyja varen nga njëra-tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për. Kjo sjell se skenari i jetës që vetëgjenerohet rrëzohet plotësisht. Prof. Leslie Orgel, një evolucionist me reputacion nga universiteti i San Diegos, Kalifornia, rrëfen këtë fakt në numrin e shtatorit të vitit 1994 të revistës Scientific American (Amerikani shkencor):

Është totalisht e pamundur që proteinat dhe acidet nukleike, të dyja këto me strukturë mjaft komplekse, të shfaqen spontanisht në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Më tepër akoma, duket e pamundur të kesh njëri pa pasur tjetrin. Kështu, në pamje të parë, mund të konkludojmë se jeta nuk mund të ketë lindur kurrë nëpërmjet proceseve kimike. 7)

Pa dyshim se nëse është e pamundur që jeta të ketë lindur nga shkaqe natyrore, atëherë duhet pranuar se jeta «u krijua» në një mënyrë supernatyrore. Ky fakt bën të pavlefshme teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohojë krijimin.

MEKANIZMA IMAGJINARË TË EVOLUCIONIT.

Pika e dytë e rëndësishme që mohon teorinë e Darvinit është se konceptet e «mekanizmave evolucionarë» të saj në të vërtetë nuk kanë asnjë fuqi evolucionare në vetvete.

Darvini e bazoi teorinë e tij, tërësisht, mbi mekanizmin e «seleksionimit natyral». Rëndësia që i kushtoi këtij mekanizmi është evidente në librin e tij Origjina e Specieve, Me anë të seleksionimit natyral....

Seleksionimi natyral citon se ato gjallesa që janë më të forta dhe më të përshtatshme për kushtet natyrale të mjedisit të tyre do të mbijetojnë në luftën e jetës. Për shembull, kur një kope drerësh sulmohet nga kafshët e egra, do mbijetojnë ata që vrapojnë më shpejt. Kështu, kjo kope do reduktohet në një kope më të shpejtë e më të fortë. Por, ky mekanizëm nuk do bëjë që dreri të evoluojë dhe të transformohet në një gjallesë tjetër si p.sh. kali.

Prandaj mekanizmi i seleksionimit natyral nuk ka fuqi evolucionare. Edhe Darvini ishte në dijeni të këtij fakti dhe e përmendi këtë në librin e tij Origjina e Specieve:

Seleksionimi natyral nuk mund të bëjë asgjë derisa të ndodhin ndryshime apo variacione individuale të favorshme. 8)

PËR PJEKJET E LAMARKUT

Si mund të ndodhnin këto «variacionet e favorshme»? Darwin u përpoq t'i përgjigjej kësaj pyetjeje nga pikëpamjet primitive të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Lamark, që jetoi para Darvinit, gjallesat i kalonin brezave pas tyre ndryshimet që fitonin gjatë jetës, dhe këto ndryshime duke u mbledhur nga brezi në brez bënin që të formoheshin specie të reja. Sipas Lamarkut,

xhirafat evoluan nga antilopat pasi meqë ato orvateshin të hanin gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën duke kaluar nga një brez në tjetrin.

Edhe Darvini dha shembuj të ngjashëm në librin e tij ku thoshte se disa arinj duke shkuar nën ujë për të gjetur ushqim u transformuan në balena me kalimin e kohës. 9)

Sidoqoftë, ligjet e trashëgimisë të zbuluara nga Mendeli dhe të vërtetuara nga gjenetika, e cila lulëzoi në shekullin e 20-të, e shkatërroi plotësisht legjendën se ndryshimet i kalonin brezave pasardhës. Në këtë mënyrë, seleksionimi natyror nuk mund të quhej më një mekanizëm evolucionar.

NEO-DARVINIZMI DHE MUTACIONET

Për të gjetur një zgjidhje, Darwinistët zhvilluan në fund të viteve 1930 një «Teori Sinteze Moderne» ose siç njihet ndryshe, Neo-Darvinizmi. Neo-Darvinizmi cilësoi fenomenin e mutacioneve, që janë deformime të gjeneve të gjallesave për shkak të faktorëve të jashtëm si p.sh. rrezatimet, si «shkak për variacione të favorshme».

Sot, modeli që nënkupton evolucionin në botë, është Neo-Darvinizmi. Kjo teori pohon se miliona gjallesa mbi tokë u formuan si rezultat i një procesi ku organe të shumta dhe komplekse si sytë, veshët, mushkëritë dhe krahët, iu nënshtruan «mutacioneve», d.m.th. çrregullimeve

gjenetike. Por ekziston një fakt i pamohueshëm shkencor i cili e hedh poshtë këtë teori. Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat; përkundrazi, gjithmonë i dëmtojnë ato.

Shembulli për këtë është shumë i thjeshtë: ADN-ja ka një strukturë shumë komplekse dhe efekte të rastit vetëm mund ta dëmtojë atë. Gjenetisti amerikan B.G. Ranganathan e shpjegon këtë si më poshtë:

Së pari, mutacionet e pastra janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme meqë ato janë të rastësishme, dhe jo ndryshime të renditura e të rregullta, në strukturën e gjeneve; çdo ndryshim i rastit në një sistem shumë të rregullt do sjellë vetëm dëme. Për shembull, nëse një tërmet godet një ndërtesë, do ndodhte një ndryshim i rastësishëm në infrastrukturën e saj i cili padyshim që nuk do ishte një përmirësim. 10)

Jo për çudi, por nuk është vëzhguar asnjë shembull mutacioni të vlefshëm, d.m.th. që të ketë zhvilluar një kod gjenetik. Është provuar se të gjitha mutacionet kanë qënë të dëmshme. U kuptua se mutacioni, që u paraqit si një «mekanizëm evolucionar» është në fakt një ndodhi gjenetike që i dëmton gjallesat dhe i lë ato të paafta. (efekti më i zakonshëm tek njerëzit është kanceri). Pa dyshim, një mekanizëm destruktiv nuk mund të jetë një «mekanizëm evolucionar». Nga ana tjetër seleksionimi natyral «nuk mund të bëjë dot asgjë vetëm» siç e pranoi dhe vetë Darvini. Ky fakt tregon se nuk ka asnjë «mekanizëm evolucionar» në natyrë. Meqë nuk ekziston asnjë mekanizëm evolucionar, nukmund të ekzistojë as edhe një proces imagjinar i quajtur «evolucion».

MBETJET FOSILE: ASNJË GJURMË FORMASH TË NDËRMJETME.

Dëshmia më e qartë se skenari i sugjeruar nga teoria e evolucionit nuk është zhilluar janë mbetjet fosile. Sipas teorisë së evolucionit, çdo gjallesë ka ardhur nga një paraardhëse. Një specie ekzistuese është shndërruar në një tjetër me kalimin e kohës dhe të gjitha speciet kanë ardhur në këtë mënyrë. Sipas teorisë, ky transformim ndodhi gradualisht me miliona vjet.

Po të ishte kështu, duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar shumë lloj gjallesash të ndërmjetme në këtë periudhë transformimi.

P.sh., duhej të kenë ekzistuar në të kaluarën gjallesa gjysëm-peshk/gjysëm-zvarranik të cilët kanë marrë vetitë e zvarranikut nga vetitë e peshkut që kishin. Ose duhej të kishin ekzistuar zogj-zvarranikë, të cilët kishin vetitë e zogjve dhe të zvarranikëve. Meqë këto do të ishin në një gjëndje kalimtare, ato duhet të ishin gjallesa të gjymtuara dhe me të meta. Evolucionistët i referohen këtyre krijesave imagjinare, të cilat besohet se kanë jetuar në të shkuarën si «forma kalimtare».

Nëse kafshë të tilla kanë ekzistuar me të vërtetë, duhet të kishte miliona apo biliona prej tyre në numër dhe varietete. Dhe më e rëndësishmja, këto krijesa të çuditshme duhet të ishin të pranishme në mbetjet fosile. Në Origjina e Specieve, Darvini shpjegon:

Sikur të vërtetohej teoria ime, duhet të ekzistojnë patjetër variete të ndërmjetme të panumërta, të cilat lidhin bashkë ngushtë të gjitha speciet e të njëjtit grup.... Si rrjedhim, gjurmët e ekzistencës së tyre mund të gjenden vetëm në mbetjet fosile. 11)

SHPRESAT E COPËTUARA TË DARVINIT

Edhe pse evolucionistët kanë bërë përpjekje të palodhshme për të gjetur fosile, që nga gjysma e shekullit të 19-të në gjithë botën, nuk është zbuluar akoma asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet e gjetura nga gërmimet kanë treguar se, përkundër pritjeve të evolucionistëve, jeta në tokë u shfaq papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontologjist i famshëm britanik, Derek V. Ager, pranon këtë fakt edhe pse ai është evolucionist:

Problemi lind se kur ekzaminojmë fosilet në detaje, në nivel specimesh ose rendi, nuk gjejmë, vazhdimisht, evolucion gradual, por një zhvillim të menjëhershëm të një grupi në kurriz të një tjetri. 12)

Kjo do të thotë se tek fosilet, të gjitha gjallesat shfaqen papritur të formuara plotësisht pa forma kalimtare mes tyre. Kjo është e kundërta e supozimit të Darvinit. Gjithashtu, është shumë e qartë se gjallesat janë krijuar. Shpjegimi i vetëm i faktit se gjallesat shfaqen papritur të plota në çdo detaj pa një paraardhës «zhvillues» është se ato janë krijuar. Ky fakt pranohet dhe nga biologu evolucionist i njohur Douglas Futuyma:

Mes krijimit dhe evolucionit shterohen shpjegimet e mundshme për origjinën e gjallesave. Organizmat ose u shfaqën plotësisht të formuar ose jo. Nëse jo, ato duhet të jenë zhvilluar nga një specie e mëparshme me një proces modifikimi. Nëse janë shfaqur plotësisht të formuara duhet të jenë formuar padyshim nga një inteligjencë e gjithëpushtetshme. 13)

Fosilet tregojnë se gjallesat u shfaqën në një gjëndje të përkryer mbi tokë. Kjo tregon se «origjina e specieve» është, ndryshe nga supozimet e Darvinit, krijim dhe jo evolucion.

PËRRALLA E EVOLUCIONIT NJERËZOR

Çështja më e përmendur e mbrojtësve të teorisë së evolucionit është ajo e origjinës së njeriut. Thëniet e darvinistëve pranojnë se njeriu i sotëm modern evoluoi nga disa lloj majmunësh. Gjatë këtij procesi të menduar evolucionar, i cili supozohet të ketë filluar 4-5 milionë vjet më parë, pranohet se kanë ekzistuar disa «forma kalimtare» ndërmjet njeriut dhe paraardhësit të tij. Sipas këtij skenari tërësisht imagjinar, renditen katër «kategori» kryesore:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i quajnë paraardhësit e parë majmunë «australopitekë» që do të thotë «majmun i Afrikës së Jugut». Këto gjallesa nuk janë gjë tjetër veçse një lloj i vjetër majmunash që është zhdukur. Kërkime të shumta, të bëra mbi australopitekë të ndryshëm nga dy anatomistë të njohur në gjithë botën nga Anglia dhe Sh.B.A, të quajtur Lord Solli Zukerman dhe prof. Çarls Oksnard,

kanë treguar se ata i përkisnin një lloji të zakonshëm majmunash që u zhduk dhe nuk shfaqte ngjashmëri me njerëzit. 14)

Evolucionistët e klasifikojnë fazën tjetër të zhvillimit njerëzor si «homo» ose «njeri». Sipas mendimit të tyre, gjallesat e klasifikuara në këtë seri janë më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët kanë projektuar një skemë të trilluar evolucioni ku kanë vendosur fosile të ndryshme të këtyre krijesave në një renditje të caktuar. Kjo skemë është imagjinare sepse nuk është provuar kurrë se ka një lidhje evolucionare ndërmjet këtyre klasave të ndryshme. Ernest Maier, një nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit të shek. të 20-të thotë në librin e tij:

Një argument i gjatë si origjina e jetës ose homo sapiens është shumë i vështirë dhe mund t'i rezistojë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm. 15)

Duke skicuar zinxhirin lidhës «Australopitekë > Homo habilis > Homo erectus > Homo sapiens», evolucionistët nënkuptojnë se secila nga këto specie është paraardhëse e tjetrës. Megjithatë, zbulimet e fundit të paleoantropologjistëve tregojnë se australopitekët, homo habilis dhe homo erectus jetuan njëkohësisht në pjesë të ndryshme të botës. 16)

Më tepër, një segment i caktuar njerëzish i përkufizuar si Homo erectus kanë jetuar deri në kohët moderne. Homo sapiens i Neandertalit dhe Homo sapiens sapiens (njeriu modern) bashkëjetuan në të njëjtën zonë. 17) Kjo situatë tregon dukshëm mosvlershmërinë e pohimit se janë paraardhës të njëri-tjetrit. Një paleontologjist i Universitetit të Harvardit, Stefen J. Guld, shpjegon këtë pikë të verbër të teorisë së evolucionit edhe pse është edhe ai vetë evolucionist:

Çfarë i ndodh lidhjes tonë nëse ka tre linja hominidësh bashkëekzistuese, ku asnjëri nuk ka rrjedhur nga tjetri? Për më tepër, asnjëri nga të tre shfaq tendenca evolucionare gjatë qëndrimit të tyre në tokë. 18)

Shkurt, skenari i evolucionit njerëzor, i cili shihet të mbahet me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të disa krijesave «gjysëm njeri, gjysëm majmun» që shfaqen në media të ndryshme dhe libra shkencorë, d.m.th. me mjete propagande, nuk është gjë tjetër veçse një përrallë pa baza shkencore.

Lordi Solly Zuckerman, një nga shkencëtarët më të famshëm dhe të respektuar të Britanisë së Madhe, i cili bëri kërkime mbi këtë temë për vite me rradhë, dhe veçanërisht fosilet e Austraolpitekut për 15 vjet, më në fund arriti në përfundimin, edhe pse evolucionist, se në fakt nuk ka një degëzim të tillë që nis nga majmuni e mbaron te njeriu.

Zuckerman bëri gjithashtu një «spektër shkence» interesant. Ai formoi një spektër duke rradhitur fushat e ndryshme nga shkencoret tek joshkencoret. Sipas këtij spektri, disiplinat më «shkencore», d.m.th. që mbështeten në të dhëna konkrete, konsiderohen kimia dhe fizika. Pas tyre vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat sociale. Në ekstremin tjetër të këtij spektri, që është dhe pjesa e konsideruar më «joshkencore», janë «perceptionet ekstra-sensoriale», koncepte të tilla si telepatia dhe shqisa e gjashtë, dhe në fund fare «evolucionin njerëzor». Zuckerman shpjegon kështu arsyet e tij:

...Pastaj ne zhvendosemi, nga pjesa e së vërtetës objektive, në ato fusha të supozuara biologjike si perceptioni ekstrasensorial apo historia e interpretimit të fosileve të njeriut, ku edhe më besniku

(evolucionist) nuk ka çfarë të bëjë - dhe ku besimtari më i flaktë (në evolucion) shpesh është në gjendje të besojë njëkohësisht gjëra të kundërta. 19)

Përralla e evolucionit njerëzor mbahet në këmbë nga disa interpretime të paragjykuara të fosileve, të zbuluara nga njerëz të caktuar, të cilët e ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

TEKNOLOGJIA E SYRIT DHE E VESHIT

Një temë tjetër interesante që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e përkryer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë tek tema e syrit, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes: «Si shikojmë ne?». Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt bien në retinën e syrit. Këtu, këto rreze transmetohen nëpërmjet sinjaleve elektrike të qelizave nervore dhe arrijnë një pikë të vogël që ndodhet në pjesën e pasme të trurit që quhet “qendra e shikimit”. Pas një sërë procesesh në këtë qendër, këto sinjale perceptohen si figura. Me këtë bazë teknike, le të arsyetojmë pak më tepër.

Truri është i izoluar nga drita. Kjo do të thotë që brendësia e tij është masë e errët ku ajo nuk kalon. Drita gjithashtu nuk do kalojë as në qendrën e shikimit; madje ky mund të jetë vendi më i errët që mund të njihni. Megjithatë, nga kjo errësi e plotë, mund të shikojmë një botë të ndritshme e plot ngjyra.

Figura e formuar në sy është aq e mprehtë dhe e qartë saqë as teknologjia e shek. të 20-të nuk ka qenë e aftë ta përftojë. P.sh., shikoni librin që po lexoni, duart që e mbajnë atë dhe pastaj ngrije kokën dhe vështro rreth e rrotull. A keni parë ndonjëherë një pamje më të qartë se kjo diku tjetër? Edhe ekranët më të zhvilluar të televizioneve nga prodhuesit më të fuqishëm të botës, nuk mund të riprodhojnë një imazh kaq të mprehtë, me ngjyra dhe 3-dimensional për ju. Për më shumë se 100 vjet, qindra inxhinjerë janë përpjekur të fitojnë këtë mprehtësi. U ndërtuan fabrika gjigande, u bënë kërkime të shumta, plane e projekte, për këtë qëllim. Shiko përsëri librin dhe pastaj në një ekran televizori. Do shikoni një ndryshim të madh. Për më tepër, televizori ju jep një pamje 2-dimensionale.

Për vite me rradhë, dhjetëra, mijëra inxhinjerë janë përpjekur të realizojnë një TV 3-dimensional. Në fakt ata e kanë realizuar një televizion të tillë por nuk është e mundur ta shohësh pa vënë syze specifike për të. Pra, është diçka artificiale. Gjithashtu ata asnjëherë nuk kanë mundur të arrijnë cilësinë e syrit në pajisjet e tyre. Si tek kamera ashtu dhe tek televizori ka humbje të cilësisë së pamjeve.

Evolucionistët pohojnë se mekanizmi që na jep këto pamje të detajuara dhe të qarta është krijuar rastësisht. Tani, nëse dikush ju thotë se televizori në dhomën tuaj është krijuar rastësisht, se të gjithë atomet e tij rastisën të ndodheshin të gjithë bashkë dhe prodhuan këtë pasjisje, ju çfarë do mendonit? Si mundet që atomet të bëjnë atë që 100-ra njerëz nuk mundin?

Nëse një pajisje, që prodhon një pamje më pak cilësore se syri, nuk mund të krijohet rastësisht, atëherë është e qartë se syri dhe pamja e parë prej tij nuk mund të krijohen rastësisht. E njëjta situatë vlen dhe për veshin. Veshi i jashtëm kap tingujt dhe i drejton ato në veshin e mesëm; veshi

i mesëm transmeton vibrimet e tingujve të amplifikuara; veshi i brendshëm i dërgon këto vibrime në tru duke i transformuar ato në sinjale elektrike. Si tek syri, veprimi i dëgjimit finalizohet në qendrën e dëgjimit të trurit.

Situata e syrit është e vërtetë dhe për veshin. D.m.th., truri është i izoluar nga tingujt njësoj si nga drita: aty nuk futet asnjë tingull. Prandaj, sado zhurmë të ketë jashtë, brendësia e trurit është tërësisht në qetësi. Por, edhe tingulli me i mprehtë kapet nga truri. Ne dëgjojmë simfonitë e një orkestre apo zhurmat në një vend me njerëz. Por nëse do arrinim të masnim nivelin e tingujve në tru me një aparaturë të saktë, në atë moment, do shikonim se aty ka qetësi të plotë.

Si me rastin e pamjeve vizive, është munduar të gjenerohet dhe riprodhohet një tingull i ngjashëm me origjinalin. Rezultat i këtyre përpjekjeve janë regjistruerit e tingujve, sistemet Hi-Fi (High Fidelity, besueshmëri e lartë) dhe sistemet e kapjes së tingujve (me sensorë). Pavarësisht nga kjo teknologji e lartë dhe qindra inxhinjerëve dhe ekspertëve që kanë punuar, nuk është përfutur akoma ndonjë tingull që ka mprehtësinë dhe qartësinë e tingullit të perceptuar nga veshi. Edhe sistemet më të njohura Hi-Fi të botës, të prodhuara nga kompanitë më të mëdha të industrisë së muzikës, kanë humbje të tingullit gjatë regjistrimit (kur ndizni një magneton gjithmonë dëgjohet një zhurmë në sfond para se të fillojë muzika). Veshi i njeriut asnjëherë nuk nxjerr këto zhurma por tingulli i perceptuar prej tij është i pastër dhe i qartë. Kështu ka qenë që në krijimin e njeriut.

Pra, nuk ka asnjë aparat pamjesh apo tingujsh të prodhuar nga njeriu që të jetë po aq i ndjeshëm dhe i saktë në perceptimin e të dhënave ndijore sa syri dhe veshi.

Megjithatë, shtrohet një fakt.

Kujt i përket aftësia e shikimit dhe dëgjimit në tru?

Kush e vështron botën e larmishme, dëgjon simfonitë dhe zogjtë apo ndjen aromën e trëndafilave?

Ngacmimet që vijnë nga sytë, veshët apo hunda e njeriut vijnë në tru si impulse nervore elektrokimike. Në librat e biologjisë, psikologjisë dhe biokimisë ka shumë detaje se si formohet një pamje në tru. Por nuk do gjeni kurrë një fakt të rëndësishëm të kësaj teme. Kush i percepton këto impulse nervore elektrokimike si pamje, tinguj, aroma apo ndjesi të tjera në tru? Kjo ndjenjë apo koshiencë e perceptuar nga truri padyshim nuk i detyrohet nervave, shtresës së trashë dhe neuroneve, përbërseve të trurit. Prandaj dhe darvinistët, të cilët besojnë se çdogjë përbëhet nga lënda, nuk i japin dot përgjigje këtyre pyetjeve.

Kjo ndjenjë është shpirti i krijuar nga Allahu. Shpirti nuk ka nevojë për sytë të shohë apo për veshët që të dëgjojë tingujt. Madje, ai nuk ka nevojë as për trurin.

Çdokush që lexon këtë fakt shkencor dhe të shtjelluar duhet të kujtojë Allahun e Gjithfuqishëm, të ketë frikë Atë dhe të kërkojë strehë tek Ai, Ai i cili e mbledh të gjithë universin në një vend të vogël, të errët në një formë të ndritshme tre-dimensionale plot ngjyra dhe ndriçim.

NJË FË MATERIALISTE

Informacioni që iu kemi paraqitur deri tani na tregon se teoria e evolucionit është dukshëm në kundërshtim me gjetjet shkencore. Thënie të teorisë mbi origjinën e jetës nuk janë në përputhje me shkencën, mekanizmat evolucionarë që ajo propozon nuk kanë fuqi evolucionare dhe fosilet tregojnë se format e ndërmjetme nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, si rrjedhim teoria e evolucionit duhet vënë mënjanë si një ide joshkencore. Ajo është njësoj si dhe fakte të tjera që u përjashtuan nga shkencën si p.sh. modeli «toka qendër e universit».

Megjithatë, teoria e evolucionit nuk përjashtohet nga shkencën. Madje disa njerëz përpiqen t'i shfaqin kritikën kundër teorisë si «sulme ndaj shkencës». Pse?

Arsyeja është se teoria e evolucionit është një bestyturi e domosdoshme dogmatike për qarqe të caktuara. Këto qarqe janë verbërisht të përkushtuar ndaj filozofisë materialiste dhe përdorin Darwinizmin si shpjegimin e vetëm materialist që mund të vihet para ligjeve të natyrës.

Është interesante pasi ata shpesh e pranojnë këtë fakt. Një gjenetist i famshëm dhe gjithashtu evolucionist i njohur, Riçard C. Leuontin nga Universiteti i Harvardit, rrëfen se ai është «së pari dhe mbi të gjitha një materialist, pastaj një shkencëtar».

Nuk janë metodat apo institutet shkencore që na detyrojnë të pranojmë një shpjegim shkencor të dukurive të botës por, përkundrazi, se detyrohemi, nga lidhja jonë a priori ndaj çështjeve materiale, të krijojmë një aparat investigimi dhe një bashkësi konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, edhe pse msitike dhe kundër intuitës. 20)

Ka shumë shpjegime të shtjelluara se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë vetëm për lidhjen ndaj filozofisë materialiste. Kjo dogmë thotë se s'ka asgjë përveç lëndës. Nga ana tjetër thuhet se lënda jo e gjallë, jokoshiente, krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona gjallesa të ndryshme; si zogjtë, peshqit, insektet, pemët, lulet, njerëzit, lindën si rezultat i bashkëveprimit të lëndëve si shiu, vetëtimja, etj. Ky është një perceptim në kundërshtim me arsyen dhe shkencën.

Çdokush që nuk e shikon krijimin e gjallesave me sy materialist do vërejë të vërtetën e qartë: Të gjitha gjallesat janë punë e një Krijuesi, i Cili është i Gjithëfuqishëm, i Gjithëpushtetshëm dhe i Gjithëditur. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi të gjithë universin nga asgjë, e zbukuroi atë në formën më të bukur dhe modeloi të gjitha gjallesat

TEORIA E EVOLUCIONIT ËSHTË MAGJEPSJA MË E FUQISHME NË HISTORINË E BOTËS

Duhet të bëhet e qartë se çdokush që nuk ka paragjykime apo ndonjë influencë ideologjike, që përdor logjikën dhe arsyen e tij, do ta kuptojë se feja në teorinë e evolucionit është e pamundur. Siç u sqarua më lart, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula mund të prodhonin mendime, profesorë, studentë universitarë, shkencëtarë si Ainshtaini dhe Galilei, artistë si Bogart, Frenk Sinatra dhe Pavaroti, etj. Për më tepër, shkencëtarët dhe profesorët që besojnë në këtë gjë të pakuptimtë janë njerëz të edukuar. Prandaj është e justifikueshme të thuhet se «teoria e evolucionit është mashtrimi më i fuqishëm në

historinë e botës». Asnjë besim apo ide tjetër nuk ka zhdukur forcën e arsyes të njerëzve, i ka ndaluar ata nga të menduarit inteligjent dhe ka fshehur të vërtetën prej tyre si të ishin të verbër. Kjo është një verbëri më e madhe se adhurimi i egjiptianëve ndaj Perëndisë së Diellit, Rà, adhurimi totem në disa pjesë të Afrikës, njerëzve të Sabës ndaj Diellit, fiset e Profetit Ibrahim ndaj idhujve të tyre, etj.

Në fakt kjo situatë është një mungesë arsyetimi e cituar nga Allahu në Kur'an. Ai tregon në shumë ajete se mendjet e shumë njerëzve do mbyllen dhe do jenë të pafuqishme ndaj të vërtetës. Disa nga ajetet janë si më poshtë:

Në të vërtetë për ata që nuk besojnë është njësoj nëse ti i këshillon apo nuk i këshillon, ata nuk do të besojnë. Allahu ka vulosur zemrat dhe dëgjimin e tyre dhe në sy kanë perde. Për ta do të ketë ndëshkim të madh.

(Sure el-Bekare: 6-7)

...Ata kanë në vete zemra me të cilat nuk kuptojnë, ata kanë në vete sy me të cilët nuk shohin, ata kanë në vete veshë që nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëti. Jo akoma më keq. Ata! Ata janë krejt të pamend e të hutuar.

(Sure el-A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një portë nga qielli dhe ata të vazhdonin të ngjiteshin atje, ata sigurisht që do të thoshin: “Na u morën sytë, bile jemi popull i magjepsur me magji”.

(Sure el-Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa habitëse është fakti që kjo magjepsje të mund të mbajë një popullatë kaq të madhe në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos bjerë për 150 vjet. Është e kuptueshme se një ose disa njerëz mund të besojnë gjëra të pamundura apo thënie të marra apo jollogjike. Megjithatë, «magjia» është shpjegimi i vetëm për njerëzit në mbarë botën të cilët besojnë që atomet e pajetë papritur vendosën të grupohen dhe të formojnë një univers që funksionon me një sistem të qëndrueshëm organizimi, disipline, arsyeje dhe koshience, me planetin Tokë dhe të gjitha veçoritë e tij aq të përshtatshme për jetën dhe me një numër të pafund sistemesh komplekse.

Në fakt, Allahu e tregon në Kur'an në ndodhinë e Profetit Musa (a.s.) dhe Faraonit, se disa njerëz të cilët mbështesnin filozofitë ateiste, influencenin të tjerët me magji. Kur Faraonit iu tregua kush ishte feja e vërtetë, ai i tha Musasë të takohej me magjistarët e tij. Kur Musai (a.s.) i takoi, u tha atyre të shfaqnin të parët aftësitë e tyre. Ajetet vazhdojnë:

Ai tha: “Hidhni ju të parët!” Kështu kur ata hodhën, ata i magjepsën sytë e njerëzve duke u futur tmerrin atyre. Dhe vërtet ata paraqitën një magji maramendëse.

(Sure al-A'raf:116)

Siç e shohim, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtronin këdo përveç Musasë(a.s.) dhe atyre që besonin në të. Megjithatë, provat e Musasë (a.s.) e prishën magjinë, ose “përpinë çfarë ata trilluan” siç e thotë dhe ajeti:

Dhe Ne e frymëzuam Musain: “Hidhe ti shkopin tënd”, por ç'të shohësh! Ai i përpiu menjëherë gjithë magjitë mashtruese që ata trilluan.

(Sure al-A'raf: 117-119)

Siç mund ta shohim nga këto ajete, kur u kuptua se këta njerëz, të cilët më parë i magjepsën të tjerët, kishin bërë thjesht një iluzion, ata e humbën tërë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët e sotme, përsa kohë ata, që nën ndikimin e një magjepsjeje të ngjashme besojnë në thënie të tilla qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetën e tyre duke i mbrojtur, padyshim që një ditë do të poshtërohen kur e vërteta të dalë në pah dhe të prishet magjepsja. Në fakt, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi shqetësimin e tij mbi këtë studim:

Unë vetë jam i bindur se teoria e evolucionit, sidomos zgjerimet që ka pësuar, do të jetë një nga shakatë më të mëdha në librat e ardhshëm të historisë. Pasardhësit tanë do mrekullohen se u mund të pranohej një hipotezë kaq e paqëndrueshme dhe e dyshimtë me kaq besueshmëri sa ka ajo.²¹⁾

Kjo e ardhme nuk është shumë e largët: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do shohin se «rastësia» nuk është zot dhe se teoria e evolucionit është mashtrimi më i keq dhe magjepsja më e tmerrshme në botë. Kjo magjepsje ka filluar tashmë të largohet nga supet e shumë njerëzve në gjithë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e vërtetë të teorisë së evolucionit habiten se sa të rrëmbyer ishin prej saj.

Ata thanë: “Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç’na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, më i Urti Gjithëgjykues.”

(Sure el-Bekare: 32).